

IMAM AHMED IBN HANBEL

Bazat e
SUNETIT

Me shpjegimet e shejkh Ahmed en Nexhmij

أصول السنة

Titulli në origjinal: أصول السنة

Autor: **Imam AHMED ibn HANBELI**

Shpjegues: **Shejkh AHMED en NEXHMIJ**

Përktheu: **SHUAJB REXHA**

Kopertina dhe faqosja: **RAJAN ALLIU**

Boton: **Qendra "Udha e Besimtarëve"**©
www.udhaebesimtaeve.com

Tiranë 2014

Biografi e shkurtër rreth imam Ahmed ibn Hanbelit

Ai quhej Ebu Abdullah Ahmed bin Muhamed bin Hanbel bin Halid bin Esed el Mazinij. U lind në Bagdad në 20 të muajit Rabil euel të vitit 164h. Ishte fëmijë i vetëm. Ishte i gjatë, esmer i theksuar, me fytyrë të bukur, i lyente flokët dhe mjekrën. Mbizotëronte tek ai qetësia, matura, frikësimi nga Allahu, por ishte dhe autoritar në mbrojtjen e të drejtës së Allahut.

Imam Ahmedi ishte nga njerëzit më bujar dhe më falënderues, ishte në një nivel të lartë edukate dhe mirësjellje të rrallë, i devotshëm, larg nga të shëmtuarat dhe gjërat e pavlera. Nuk dëgjohej prej tij gjë tjetër përveçse studimit dhe përkujtimit të haditheve, përmendjes së njerëzve të mirë, i përmendte me shprehje të mira dhe ishte asket në këtë dunja. Ka udhëtuar në kërkimin e hadithit, nga Bagdadi për në Kufeh dhe Basrah, në Ibadan, në Gadishullin Arabik, në Uasita, në Meke dhe Medine, ka udhëtuar në këmbë për në kryeqytetin e Jemenit: San`a, ka udhëtuar për në Tarsus si luftëtar, gjithashtu ka udhëtuar dhe për në Sham.

Numri i shujuhëve të tij nga të cilët ka marrë dituri dhe që përmenden në el Musned i kalon shifrën 280, ndërsa sot një studim i bërë rreth shujuhëve të tij, ka arritur në përfundimin se ata ishin 292. Ndërsa përsa u përket nxënësve që ka lënë pas, janë të përmbledhur në studimin e bërë nga njëri prej vetë këtyre nxënësve: Ibn Ebi Jala në et-Tabekat, ku numri i tyre arrin në 577.

Ai ka një sërë veprash përmbledhëse dhe të shkëlqyera, që arrijnë tek 30 vepra, ndërsa librat që janë shkruar nga të tjerët por duke përmbledhur çështjet që ai ka përmendur, pyetje-përgjigjet e realizuara prej tij, arrijnë në 200 libra. Ndër veprat e tij më madhore është libri el Musned.

Përjetoj sprovën e asaj kohe: përhapjen e mendimit të devijuar se Kurani është i krijuar, gjë me të cilën u sprovua për plot 23 vjet, duke bërë durim, qëndrim i cili solli përfundimin e lavdishëm për ehlu sunetin. Vdiq në Bagdad nga gripi, në paraditen e ditës së xhuma, në ditën e dhjetë të muajit Rabiul euel të vitit 241 Hixhri, ku i lanë xhenazenë, i falën namazin dhe u varros po në të njëjtën ditë. Mosha e tij arriti 77 vjeç e 11 muaj. Allahu e mëshiroftë dhe e bëftë nga banorët e xhenetit.

(Marrë shkurtimisht nga libri:el Medkhal el mufesal 323-419 të shejkhut Bekr Ebu Zejd).

Biografia e shejkhut Ahmed en-Nexhmij¹

Pyetësi thotë: Kërkojmë nga hirësia juaj të na e bëni një njohje rreth personalitetit tuaj.

Shejkhu thotë: Falënderimet dhe lëvdatat i përkasin Allahut. Salavatet dhe përsëndetjet qofshin mbi Profetin salAllahu alejhi ue selem, mbi familjen dhe shokët e tij, e më pas:

Vëllai juaj, Ahmed bin Jahja bin Muhamed bin Shubejr en-Nexhmij, i lindur në fshatin Nexhamijeh². Jam lindur në fund të vitit 1346h. Kam mësuar Kur'anin tek Shkruesit³ tre herë, para se të vinte aty shejkhu ynë, Abdullah el-Karauj. Pas ardhjes së shejkhut dhe ngritjes së shkollës selefije në Samitah në 1359h, shkoja here pas here por nuk e vazhdova në mënyrë të rregullt atë vit. Pastaj në fillim të vitit pasues, 1360h, në muajin Sefer, hyra në shkollën Selefije të Samitas. Kjo shkollë u ngrit nga shejkhu ynë, thirrësi i mirënjohur, me të cilin Allahu ka shpëtuar një popull të tërë në zonën e Xhazanit, duke i nxjerrë nga shirku në teuhid, nga injoranca në dituri, nga gjynahet dhe bidatet në devotshmëri dhe iman.

Falënderimi i takon Allahut që vazhdova mësimin në shkollën e shejkhut derisa në vitin 1365h shejkhu më caktoi si mësues në shkollën e Nexhamijes dhe në xhaminë e cila është pranë shtëpisë sime. Pra, jepja mësim aty dhe në të njëjtën kohë mësoja në shkollën Selefije, pastaj në vitin 1367h u caktova

¹ Shejh Ahmed en-Nexhmij është autori i shpjegimeve rreth Bazave të Sunetit të shkruara nga imam Ahmed bin Hanbeli.

² Fshat nga fshatrat e zonës së Xhazanit në jug të qytetit të Samitas në një largësi prej 4 kilometrash

³ Shkruesit janë ata që marrin fëmijët e fshatit për t'ua mësuar atyre shkrimin, leximin dhe Kur'anin

zyrtarisht si mësues në të njëjtën shkollë. Në vitin 1372 u caktova imam dhe mësues në xhaminë Ebu Sebilih pranë qytetit Aridah (qytet i vogël, pothuajse malor dhe që ndodhet rreth 20 kilometra larg qytetit Ebu Arish) ku qëndrova dy vjet duke vajtur dhe ardhur. Më pas u hap Instituti i Dijes (el-Ma`hadul Ilmij) në Samitah në fillim të vitit 1374h ku dhe u caktova si mësues së bashku me shejkhun Hafidh el-Hakemij, Nasir Halufeh dhe një grup shujuhësh të tjerë. Kam dhënë mësim në këtë Insitut 10 vjet, pastaj u tërhoqa nga aty në vitin 1384h. Kisha dëshirë të madhe t'i bashkangjitesha Universitetit Islamik (në Medine) si mësues, sidomos në atë kohë që gjendeshin aty shejkh Muhamed Nasirudin Albani, muhadithi i njohur, si dhe shejkh AbdulAziz Bin Bazi, i cili ishte rektor i Universitetit Islamik në atë kohë. Doja shumë të kisha kontakt dhe lidhje me këta të dy e të merrja dituri prej tyre. Kjo ishte dëshira ime por nuk ishte caktim nga Allahu të ndodhte. U mundova përsëri t'i bashkëngjitem Universitetit Islamik por përsëri nuk m'u realizua diçka e tillë. Atëherë u lidha me Ministrinë e Da'ues dhe Udhëzimit, ku më caktuan si këshillues dhe predikues në zonën e Samitas, Meusim, Musarah, Ebu Arish. Qëndrova tre vjet duke u angazhuar në ato zona, duke këshilluar dhe orientuar njerëzit, mirëpo udhëtimet e shumta më lodhën dhe më dobësuan fizikisht, prandaj kërkova të më kthenin në shkolla dhe institute, falënderimi i takon Allahut që doli vendimi për t'u kthyer atje. Në fillim të vitit nuk më caktuan në Samitah por më dërguan në Institutin e Xhazanit, ku e kalova atë vit shkollor, 1387-1388h, pastaj më caktuan në Institutin e Samitas, ku vazhdova derisa më nxorën në pension në vitin 1410h. Falënderimi i takon Allahut, që nga ajo kohë nuk e kam lënë mësimdhënien pasi e kam vazhduar nëpër xhamia dhe në mexhlise. E lus Allahun të na japë përfundim të mirë, si neve ashtu dhe juve.

Këtu mbaron fjala e shejkhut rreth jetës së tij të cilën e ka shkruar nxënësi i tij, Hasen Degriri, në fillim të librit el-Fetaua el-Xhelijeh an Esiletil Menahixh ed-Dauijeh, dhe në fillim të librit Irshadus-Sarij fi Sherhis- Suneh lil Berbehari.

Më poshtë do sjellim disa fragmente nga biografia që ka shkruar shejkh Muhamed bin Hadij el-Medkhalij, rreth shejkhut të tij, Ahmed en-Nexhmij, në parathënie të librit el-Meurid el-Adhbu ez-Zulal të shejkh Ahmedit.

Emri dhe prejardhja e shejkhut:

Ai është shejkh yënë i nderuar, el-alameh, muhadithi, fakihu, muftiu i tanishëm i zonës së Xhazanit, mbajtësi i flamurit të sunetit dhe hadithit atje, shejkh Ahmed bin Jahja bin Muhamed bin Shubejr el-Shubejr nga fisi benu Humejd, një nga fiset e njohura në Xhazan. është lindur në fshatin Nexhamijeh në datë 22/10/1346h dhe u rrit në prehërin e dy prindërve të mirë, të devotshëm, duke qenë fëmijë i vetëm.

Formimi i tij (nga ana e dijes):

Pas ardhjes së shejkhut Abdullah Karauj, shkante shejkh të bashku me dy xhaxhallarët e tij, shejkh Hasen Muhamed Nexhmij dhe Husejn Muhamed Nexhmij, në qytetin Samitah disa ditë tek shejkh Abdullahi, mirëpo nuk e vazhdoi atë vit shkollën. Pastaj në vitin pasues, 1360h, iu bashkangjit shkollës Selefije dhe me porosi të shejkh Abdullahit e lexoi Kur'anin tek shejkh Uthman el-Hambij me texhuid. Pastaj mësoi përmendësh (librat në vijim): Tuhfetul Etfal, Hidajetul Mustefid, Thelathetul Usul, Erbein Neueujeh, el-Hisab dhe në

të njëjtën kohë përsosi mënyrat e shkrimit. Ulej në mexhlinis e nxënësve të vegjël, në të cilin e kishte vendosur shejkhun derisa të mbaronte ai mexhli pas dreke, pastaj i bashkëngjitej mexhlisit të nxënësve të mëdhenj në të cilin jepte mësim shejkh Abdullahi dhe rrinte aty që nga pas namazit të drekës deri në namazin e jacisë, pastaj kthehej me dy xhaxhallarët e tij në fshat. Pas katër muajsh shejkh Abdullahi e lejoi që të merrte pjesë në mexhlinis e nxënësve të mëdhenj, në të cilin ka lexuar me shejkhun (librat në vijim): err-Rrahbijeh në lëndën e trashëgimisë; el-Exhrumijeh në lëndën e Nahues (në rregullat gjuhësore); Kitabut-Teuhid (në akide), Bulugul Meram (në hadith), el-Bejkunijeh (në lëndën e hadithit), Nuhbetul Fikr (në lëndën e hadithit) së bashku me shpjegimin e saj: Nuz-hetun-Nedhar; Muhtesaratun fis-Sirah (histori profetike), Tesrif el-Gizij (në gjuhë), el-Auamil fin-Nahui Mieh (në rregullat e gjuhës), el-Uerakat (në bazat e fikhut), el-Akidetu et-Tahauije me shpjegim të shejkh Abdullah Karauij, para se t'u binte në dorë shpjegimi i Ibn Ebil Iz el-Hanefij. Ka mësuar një pjesë nga el-Elfije të Ibn Malikut (në rregullat e gjuhës), ed-Durarul Behijeh me shpjegimin e saj: ed-Derarij el-Mudijeh, në lëndën e fikhut (të dy librat janë të imam Sheukanit), e libra të tjerë, qofshin ato libra të caktuara si lëndë mësimore, siç i përmendëm më parë, apo libra të tjerë që i kanë mësuar për të shtuar njohuritë, apo libra që i kanë përdorur për kërkimin e çështjeve të ndryshme, nga këto libra psh: Nejlul Eutar, Zadul Mead, Nurul Jekin, el-Mu-uetta, el-Umehat. Në vitin 1362h, shejkh Abdullahi u shpërndau nxënësve vëllimet e librave bazë (në hadith) që gjendeshin në bibliotekën e tij: Dy

Sahihet, Sunen Ebi Daud, Sunen Nesai, el Mueta të imam Malikut, dhe filluan t'i lexonin (t'i studionin) me shejkhun, por nuk i mbaruan dot pasi u shpërndanë nxënësit për shkak të thatësirës.

Në vitin 1364h nxënësit u kthyen dhe e plotësuan leximin e këtyre librave aty ku e kishin lënë, ndërsa më vonë shejkh Abdullahi i dha leje shejkh Ahmedit që të jepte mësim në librat bazë të hadithit. Në vitin 1369h ka mësuar tek shejkh Ibrahim el-Amudij- gjykatësi i Samitas në atë kohë- librin Islahul Muxhtema, si dhe librin e shejkh Abdurrahman es-Sadij në fikh: el-Irshad fi Marifetil Ahkam. Ka mësuar me porosi të shejkhut Abdullah tek shejkh Ali Sumalij librin el-Auamil fi Nahui Mieh (në rregullat e gjuhës), si dhe disa libra të tjerë në Nahue dhe Sarf. Në vitin 1364h ka marrë pjesë në mexhlin e shejkhut, imamit, el-alameh, muftiut të Saudise në atë kohë: Muhamed bin Ibrahim Ali Shejkh, për rreth dy muaj në lëndën e tefsirit, duke lexuar librin Tefsir Ibn Xherir et-Taberi. Po në të njëjtin vit ka marrë pjesë në mexhlin e shejkhut tonë, imamit, el-alameh, AbdulAziz Bin Baz, për rreth një muaj e gjysmë, duke lexuar nga Sahihul Buhari në kohën ndërmjet akshamit dhe jacisë.

Shujkhët e tij:

Nga çfarë përmendëm më lart, na bëhet e qartë kush ishin mësuesit e tij.

1. Shejkh Ibrahim el-Amudij (gjykatësi i Samitas në atë kohë)
2. Shejkh Hafidh bin Ahmed el-Hakemij
3. Shejkh, el-alameh, thirrësi, ripërtëritësi i fesë në jug të Saudisë, Abdullah el-Karauij, prej të cilit ka përfituar shumicën e diturisë

4. Shejkh Abduh Akil Nexhmij
5. Shejkh Uthman el Hambij
6. Shejkh Ali Sumalij
7. Shejkh, imami, el-alameh, muftiu i Saudisë në atë kohë, Muhamed bin Ibrahim Ali Shejkh
8. Shejkh Jahja Fakih Abesij (nga Jemeni)

Nxënësit e tij:

Shejkhun ynë ka shumë e shumë nxënës, sepse një person i cili ka një kohë kaq të gjatë në mësimdhënie, pothuajse gjysëm shekulli, sa mund të përfytyrohet të jenë nxënësit e tij?! E nëse i përmendim të gjithë, do kishim nevojë për një vëllim të tërë, por po përmendim vetëm ca shembuj për t'u kuptuar vetë të tjerët:

1. Shejkhun ynë, el-alameh, muhadithi, përkrahësi i sunetit, Rabij bin Hadij el-Medkhalij
2. Shejkhun ynë, el-alameh, fakihu, Zejd el-Medkhalij
3. Shejkhun ynë, dijetari i nderuar, Ali bin Nasr el-Fakihi

Po mjaftohemi me përmendjen e këtyre treve për shkak se janë të njohur në mjediset e dijes, prandaj shpresojmë që mos të na qortojë dikush.

Këto ishin fragmentet që shkëputëm nga biografia e shkruar nga shejkhun Muhamed el-Medkhalij, i cili është nga nxënësit e shejkh Ahmed en-Nexhmij.

Thotë Hasen Degriri, në biografinë që ka shkruar për shejkh Ahmedin:

Me këtë rast, jam i lumtur të përmend se shejkh Ahmedi ka disa shkrime (libra), një pjesë janë botuar dhe një pjesë akoma jo. Nga të botuarat përmendim:

- 1) el-Meuridu el-Adhbu ez-Zulalu Fijme Intukide ala Badil Menahixhi ed-Dauijeh minel Akaidi uel Eamal. Po ashtu ka një broshurë me të cilën i ka bërë kundërpërgjigje atij që i ka kërkuar shejkhut që mos ta botojë këtë libër dhe quhet Radul xheuab ala men talebe minij ademe tab`al Kitab.
- 2) Err-Rradu esh-Sher`ij el-Ma`kul alel Mut-tesilil Mexhhul
- 3) Vëllimi i parë i Te`silul Ahkam ala ma Saha an kHajril Enam bi Sherhi Ehadithi Umdetil Ahkam (do e ribotojmë këtë vëllim dhe së bashku me të do botohet vëllimi i dytë dhe i tretë, ndërsa shpjegimi i pjesës tjetër akoma nuk është plotësuar).
- 4) Eudahul Isharah fir- Radi ala men Ebaha el-Memnua minez- Zijarah
- 5) Tenzihu esh-Sheriah an Ibahatil Eganij el-Haliah
- 6) Risaletul Irshad ile Bejanil Haki fi Hukmil Xhihad
- 7) Fet`hu err-Rrabil Uedud fil Fetaua uer- Rasail uer- Rudud
- 8) Irshadus- Sarij fi Sherhi es-Suneh lil Berbeharij

Ka fetaua dhe libra të tjerë të cilat do botohen së shpejti, inshallah (Nga këto: Risaletun fil Xhehri bil Besmeleh, Situne Mes`eleten fis- Sijam, el-Fetaua el-Xhelijeh an Es`iletil Menahixhi ed- Dauijeh). Gjithashtu, shejkhun ka dhënë disa shënime të dobishme të disa librave dhe shpjegimeve të tyre, të cilat na i ka diktuar gjatë mësimeve të tij, shpjegimi i disave

nga këto ka mbaruar, si psh: Sherhus- Suneh të imam Ahmedit, Sherhus- Suneh të imam Berbeharit, ndërsa disa akoma nuk kanë përfunduar si psh: Shënime në lidhje me Fet'hul Barij, Shënime rreth shpjegimit të Sahihu Muslimit, Nejlul Eutarit, Aunul Mabudit, Tuhfetul Ehuedhij, Raudatun Nedijeh, Subulu Selamit. Shpjegimi i shumicës së këtyre librave që përmendëm vazhdon akoma në xhaminë e shejkhut dhe nëpër xhamitë e tjera të zonës, por që këto libra të nxirren në dritë dhe të shpërndahen mes njerëzve, kanë nevojë për bamirësa dhe njerëz që e duan diturinë, që të ndihmojnë dhe kujdesen për botimin e tyre në formën më të mirë e më të re, e nuk mund të realizohet kjo derisa dikush ta marrë përsipër këtë punë, prandaj Allahu e shpërbleftë me të mira atë që bëhet shkak në shpërndarjen e kësaj diturie tek ata që e kërkojnë. Gjithashtu Allahu e shpërbleftë me të mira shejkhun tonë të nderuar për dijen e shumtë, të dobishme e të bekuar, që u jep nxënësve të dijes duke e kaluar gjithë kohën e tij duke shkruar ose duke dhënë mësim, ose duke këshilluar dhe udhëzuar njerëzit, duke mos harruar kohën në të cilën ulet për fetua dhe për të pritur njerëzit pa ndjerë siklet apo shqetësim prej tyre, e gjithë kjo duke shpresuar në fytyrën e Allahut dhe shpërblimin e Tij.

E lusim Allahun t'ia zgjasë jetën shejkhut tonë⁴ dhe të gjithë dijetarëve të ehlu sunetit në çdo vend qofshin, si dhe të gjithë atyre që ecin në menhexhin pejgamberik dhe pasojnë gjurmët

⁴ Sh.P: Duke marrë parasysh faktin që shejhu ka ndërruar jetë, lutja e përshtatshme nga ne për të do jetë: Allahu e mëshiroftë dhe e bëftë të dobishme diturinë që la pas

e selefëve në dije dhe vepra. Allahu i shtoftë devotshmëri, dije dhe dobi me dijen e tij. Allahu na udhëzoftë ne, atë dhe të gjithë muslimanët për atë që Ai e do dhe e pëlqen nga fjalët dhe veprat, qofshin të hapta apo të fshehta. Me të vërtetë Allahu ka mundësi për çdo gjë. Ue salAllahu ala nebijina Muhamed ue ala alihi ue sahbihi ue seleme teslimen kethiran.

Parathënia e shpjguesit

Falënderimet dhe lëvdatat i përkasin Allahut, salauatet janë mbi fisnikun e profetëve dhe të dërguarve:

E më pas: Padyshim, akideja(besimi) është baza e fesë, sepse pa akide nuk mund të ketë fe që dmth se feja nuk mund të ketë vlerë dhe konsideratë me peshë pa akide të pastër. Nëse akideja nuk është e saktë atëherë edhe feja nuk është e drejtë, pra nuk mund të jetë e drejtë veçse kur të jetë akideja e shëndoshë. Prandaj Allahu i ka urdhëruar robërit e Tij që të pasojnë rrugën e drejtë: sheriatin e Allahut që e përmban Libri i Tij dhe Suneti i Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe i përmbahet praktikës së sahabëve pas Profetit salAllahu alejhi ue selem. Allahu e ka cekur këtë me fjalën e Tij ku thotë: “Kjo është rruga ime e drejtë ndaj pasojeni atë dhe mos ndiqni rrugët e tjera që të mos u shmangin nga rruga Ime”(En`am 153), gjithashtu thotë duke lavdëruar pasuesit e rrugës së drejtë, si dhe duke treguar se çfarë shpërblimi meritojnë: “Atyre që thanë: Zoti ynë është Allahu dhe u përqëndruan me vendosmëri, do u zbresin engjëjt(dhe u thonë): Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni dhe përgëzohuni me xhenetet që u premtoheshin. (Thonë): Ne jemi të dashurit dhe mbrojtësit tuaj në jetën e dunjasë dhe në Ahiret. Aty do keni çfarë të dëshironi dhe çdo gjë që u është premtuar. Mikëpritje dhe nderim nga Mëkatfalësi, Mëshiruesi”(Fusilet 30-32). Allahu duke ia tërhequr vërejtjen robit dhe të dërguarit të Tij, që njëkohësisht është tërheqje e vërejtjes dhe për të gjithë umetin pas tij, thotë: “Ne të dhamë ty sheriatin ndaj pasoje atë dhe mos i paso tekat e atyre që nuk dinë. Ata

nuk do të të bëjnë dot dobi asgjë ndaj Allahut. Zullumqarët janë palë e njëri tjetrit, ndërsa Allahu është ueliju (mbrojtësi dhe përkrahësi) i besimtarëve”(Xhathije 18-19).

Ky ajet përmban urdhërin për pasimin e sheriatit dhe ndalimin nga pasimi i diçkaje tjetër veç tij, si dhe largimin nga ata që thërrasin në rrugë tjetër nga ajo e Allahut. Allahu na lajmëroi se ata që kapen pas fesë së Tij, që pasojnë sheriatin e Tij dhe përqëndrohen në të me vendosmëri, këta janë eulijatë e Allahut dhe Allahu ueliju i tyre. Ndërsa ata që e lënë këtë rrugë dhe pasojnë të tjera veç saj, ata janë armiq të Allahut. Gjithashtu ky ajet përmban urdhërin që të kapemi pas librit të Allahut sepse ai është baza e sheriatit, po ashtu të kapemi pas asaj në të cilën ishte Profeti salAllahu alejhi ue selem dhe shokët e tij pas vdekjes së tij.

Allahu ka thënë: “Kapu pas asaj që të është shpallur, vërtetë ti je në rrugë të drejtë”(Zuhruf 43). Profeti salAllahu alejhi ue selem në hadithin që flet për përçarjen thotë: “Jehuditë u ndanë në 71 grupe, të krishterët u ndanë në 72 grupe ndërsa ky umet do të ndahet në 73 grupe, nga të cilat të gjitha do jenë në zjarr përveç njërit. Thanë: Cili është ai grup(i shpëtuar) o Rasulallah? Tha: “Janë ata që ecin sipas asaj në të cilën jam unë dhe shokët e mi”⁵.

Pra, shpëtimi i garantuar është për atë që ecën sipas librit të Allahut, Sunetit të Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe

⁵ Transmeton Ahmedi në Musned Nr. 8404, Ebu Daudi Nr. 4596, etj. E ka saktësuar Albani në shënimet e tij ndaj librit të Sunenit, ku thotë: Hadithi është i saktë padyshim sepse ka gjashtë rrugë të tjera transmetimi nga Enesi, si dhe një seri dëshmish përforcuese nga një grup sahabësh.

metodës së selefëve, të cilët e ndoqën këtë rrugë pas Profetit të tyre, kjo është rruga e ehlul ether⁶. Kur thuhet ehlul ether janë për qëllim as-habul hadith dhe nuk mund të njihet e vërteta nga e kota apo e sakta nga e gabuara veçse nëpërmjet haditheve. Ehlul hadith(pasuesit e haditheve) janë ata që i përmbahen të vërtetës atëherë kur njerëzit e tjerë humbasin, janë ata që kapen pas asaj atëherë kur njerëzit heqin dorë prej saj. Në lidhje me këtë imam Ahmedi ka thënë: Nëse nuk janë ehlul hadithi eulijatë e Allahut, unë nuk e di se kush mund të jetë tjetër⁷.

Nëse ata zhduken nga kjo tokë atëherë njerëzit marrin si prijësa të tyre injorantët të cilët u japin përgjigje pa dituri duke humbur vetet dhe të tjerët⁸.

Prandaj, o ju kërkues të diturisë, kapuni pas rrugës së ehlul hadithit ashtuqë ta kuptoni fenë tuaj, ashtuqë ta mësoni akiden e pastër, të cilën Allahu e dëshiron që të pasohet nga robërit e Tij, mos iu shmangni asaj djathtas apo majtas sepse kjo shmangie do të thotë humbje dhe dështim. Luteni gjithnjë Allahun që t`u udhëzojë në të drejtën, tua shfaqë të vërtetën ashtu siç është dhe tu japë sukses në pasimin e saj, si dhe tua

⁶Sh.p: Termat: ehlu suneh, ehlul ether,ehlul hadith, selefij, janë sinonime të njëri-tjetrit që i referohen pikërisht atyre që ndjekin Islamin e pastër burimor ashtu siç ka ardhur nga Profeti salallahu alejhi ue selem

⁷ Transmeton Ibn Muflihi në el Abadu esh-sher`ijeh 1/11.

⁸ Shejhu ka për qëllim me këtë hadithin e Abdullah bin Amrit i cili tha: E kam dëgjuar Profetin salAllahu alejhi ue selem duke thënë: "Allahu nuk e merr diturinë duke e nxjerrë nga kraharorët e atyre robërve që e mbajnë por e merr duke marrë dijetarët derisa nuk ngelet asnjë dijetar, atëherë njerëzit marrin injorantët për prijësa të cilët pyeten dhe japin përgjigje të bazuar në padituri duke humbur vetet dhe të tjerët" Transmeton Buhariu Nr. 100 dhe Muslimi 2673.

shfaqë të kotën ashtu siç është realisht dhe t`u japë sukses në largimin prej saj. Të mos u përzihet e vërteta me të kotën dhe të humbni. Kjo është rruga e drejtë për të cilën Allahu i ka urdhëruar që t`i luten Atij në çdo rekat namazi(“Na udhëzo në rrugën e drejtë”), që t`i udhëzojë në të, duke ua bërë obligim nëpërmjet Profetit salAllahu alejhi ue selem leximin e sures Fatiha në çdo rekat. Kjo sure përmban çështjet e mëposhtme:

1. Lavdërimi i Allahut duke i shprehur meritën absolute të hamdit (lavdërim, falënderim, dhe mirënjohje).
2. Cilësimi i Allahut me cilësinë e mëshirës gjithëpërfshirëse dhe mëshirës specifike në dy emrat er-Rahman, er-Rrahim.
3. Cilësimi i Tij me emrin el Melik, emër në të cilin askush nuk mund t`i bëhet ortak: “Sunduesi në Ditën e Gjykimit” (“Maliki jeumi din”). E specifikoi posedimin dhe zotërimin me Ditën e Gjykimit sepse në atë ditë nuk do ketë posedim apo sundim të dikujt tjetër veç Allahut. Kurse në dunja, Allahu u ka mundësuar robërve të Tij një lloj posedimi formal të pjesshëm që të jetë trajtë sprovimi për ta. Në Ditën e Gjykimit askush nuk posedon asgjë: “çfarë di ti rreth Ditës së Gjykimit. Edhe njëherë çfarë di ti rreth Ditës së Gjykimit. Ajo është dita në të cilën askush nuk posedon asgjë për askënd dhe e gjithë çështja i përket vetëm Allahut”(Infitar 17-19), dhe: “O ju njerëz jini të devotshëm ndaj Zotit tuaj dhe kijani frikën një Dite, në të cilën nuk i bën dot dobi prindi fëmijës së tij dhe as fëmija nuk bën dot asgjë për prindin e tij”(Lukman 33).
4. Më pas pohon dhe thekson se ibadeti(adhurimi) është e drejta absolute vetëm e Allahut, si dhe përmban

obligueshmërinë e kërkit të ndihmës vetëm nga Allahu: Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë (“Ijjake na`budu ue ijyake neste`in”).

5. Pasiqë parashtrori këto parathënie të cilat janë shkak për pranimin e lutjes, urdhëroi që t'i lutemi për udhëzim sepse Ai e posedon udhëzimin dhe humbjen: “Ihdinas-siratal mustekim” Na udhëzo për në rrugë të drejtë”. Rrugë të cilën e cilësoi duke thënë: “Në rrugën e atyre që u ke dhënë mirësi, e jo në të atyre që merituan zemërimin (Tënd) dhe as në rrugën e të humburve”

Kjo sure ka përmbledhur në vetvete të mirën në tërësi ndaj dhe Allahu na urdhëroi nëpërmjet gjuhës së Profetit salAllahu alejhi ue selem që ta lexojmë dhe na lajmëroi se nuk ka namaz (të vlefshëm) për atë person që nuk e lexon⁹”.

Së fundmi, është një çështje që duhet të jemi të vëmendshëm ndaj saj: Nëse duam që të njohim këtë rrugë të drejtë, atëherë për të arritur këtë synim, patjetër duhet t'i kthehemi Librit të Allahut dhe shpjegimit të tij me hadithe, me traditën e Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe me traditën e sahabëve pas tij, ndaj kërkohet që t'i mësojmë hadithet, nëpërmjet të cilave e njohim këtë rrugë.

Allahu ka thënë: “Nuk duhet që besimtarët të dalin të gjithë për në luftë. Nga çdo grup le të shkëputet një pjesë që të mësojnë për fenë dhe tua tërheqin vërejtjen popullit të tyre

⁹ Shejhu ka për qëllim hadithin e Ubadeh bin Samit ku Profeti *salAllahu alejhi ue selem* ka thënë: “Nuk ka namaz të vlefshëm për atë person që nuk lexon në të Fatihatul Kitabin” Transmeton Buhariu Nr. 756 dhe Muslimi Nr. 394.

kur të kthehen tek ata, me shpresë që ky përkujtim t'i bëjë ata të ruhen”(Teubeh 122).

Patjetër duhet të kemi si referencë librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit salAllahu alejhi ue selem për njohjen e rrugës së drejtë. Gjithashtu, pjesë e kësaj reference është historia e vërtetuar e Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe praktika e prijësave të drejtë pas tij. E gjithë kjo nuk mund të njihet ndryshe veçse nëpërmjet haditheve, duke arritur kuptimin në fe dhe njohjen e dispozitave të sheriatit. Nëpërmjet transmetimeve(ethereve) njohim praktikën e sahabëve, besimin e tyre, si dhe praktikën e selefëve, prijësave në fe, dijetarëve të hadithit dhe njohësve të besimit të pastër.

Kapuni pas kësaj dhe përpiquni sa të mundeni që ta njihni hadithin, sepse Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Allahu kur ia do të mirën dikujt e bën të kuptojë në fe”¹⁰.

Po ashtu meritojnë lutjen me të cilën Profeti salAllahu alejhi ue selem është lutur, ku ka thënë: “Allahu e ndriçoftë dhe hijeshoftë atë person që e dëgjon thënien time, e kupton dhe e ruan atë, e pastaj e komunikon tek ai që nuk e ka dëgjuar”¹¹. Kjo është lutje që t'i ndriçohet dhe hijeshohet fytyra. Po ashtu arrin mirësinë tjetër që përmendet në hadithin ku Profeti salAllahu alejhi ue selem thotë: “Nuk ka popull që mblidhet në ndonjë nga shtëpitë e Allahut, për të lexuar librin e Allahut dhe për ta studiuar atë mes tyre, veçse do zbresë mbi ta qetësimi, do i përfshijë mëshira, do i rrethojnë engjëjt me

¹⁰ Transmeton Buhariu nr. 71 dhe Muslimi 1037.

¹¹ Transmeton Ahmedin në Musned Nr.16738, Ibn Hibani Nr.67, Tirmidhiu Nr.2656, etj. Hadithin e ka saktësuar Albani në Silsile Sahiha nr.404.

krahët e tyre dhe i përmend Allahu tek ata që janë afër Tij(paria e lartë e engjëjve)”¹².

Kjo parathënie është një porosi për ju o kërkuesit e diturisë, që t`u shërbejë si nxitës në pasimin e rrugës së vërtetë. Shpresoj që të ndiqni këtë rrugë dhe të mos i shmangeni asaj. Allahu është që jep sukses.

¹² Transmeton Muslimi n.2699.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Hyrje në shpjegimin e Bazave të Sunetit

Më herët jemi njohur me pozitën që duhet të gëzojë akideja tek muslimani dhe se feja e tij nuk mund të jetë e drejtë pa të. Keni në dorë një libërth, i vogël për nga vëllimi por madhështor në kuptimet që bart. Ebu Ja`la el Hanbelij në lidhje me këtë libër, Bazat e Sunetit, të imam Ahmedit, ka thënë: Sikur të më duhej që të udhëtoja deri në Kinë për të kërkuar mësimin e këtyre bazave, do të ishte diçka e papërfillshme”

13

Këtë përshkrim të akides, e ka shkruar prijësi i ehlu sunetit, unanimisht si i tillë, i cili bëri qëndresë në ditët e vështira të sprovës që kishte të bënte me mendimin e devijuar të krijimit të Kuranit, derisa Allahu e bëri të vërtetën triumfuese nëpërmjet këtij imami dhe qëndresës së tij. Ai është imam Ahmed bin Hanbeli, imami i Ehlu Sunetit, i lindur në vitin 161H dhe vdekur në vitin 241H.

Shejkhu, imami Ebu Mudhafer AbdulMalik el Hemedanij ka thënë: Na ka treguar shejkhu Ebu Abdullah Jahja el Bena, tha: Na ka lajmëruar babai im Ebu Alij Hasen bin Ahmed el Bena, tha: Na ka lajmëruar Ebul Husejn Ali Bishrani, tha: Na ka lajmëruar Uthman bin Ahmed es-Semak, tha: Na ka lajmëruar

¹³ Marrë nga Tabekatul Hanabileh 1/241.

Ebu Muhamed el Hasen ibn Abdul Uehab, duke i lexuar atij nga vetë libri i tij, në muajin Rabiul Euel të vitit 293H, tha:

Na ka treguar Ebu Xhafer Muhamed bin Sulejman el Basrij në qytetin Tenis(një nga qytetet e Egjiptit), tha: Më ka treguar Abdus bin Malik el Atar tha: Dëgjova Ebu Abdullah Ahmed ibn Hanbelin duke thënë:

Bazat e Sunetit tek ne janë: Të kapurit pas asaj në të cilën kanë qenë shokët e Profetit salAllahu alejhi ue selem.

Shpjeguesi (Shejkh Ahmed en-Nexhmij) thotë: Sepse Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Kapuni pas Sunetit tim dhe sunetit të halifëve të drejtë e të udhëzuar pas meje, kapuni fort pas saj dhe shtrëngojeni me dhëmballë”¹⁴.

Të kapurit pas asaj në të cilën kanë qenë sahabët realizohet duke u kapur për Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit salAllahu alejhi ue selem, historinë e tij dhe të halifëve të tij të drejtë dhe shokëve të tij të udhëzuar. Profeti salAllahu alejhi ue selem në hadithin i cili flet për përçarjen e umetit në përshkrimin e grupit të shpëtuar, ka thënë: “Do të përçahet ky umet në 73 grupe, të gjitha do jenë në zjarr përveç njërës. Thanë: Kush janë ata(të shpëtuarit) o i Dërguari i Allahut? Tha: “Janë ata të cilët do t'i përmbahen asaj në të cilën jam unë dhe shokët e mi”.

Duke ditur këtë, i bëhet obligim nxënësit të dijës që ta lexojë historinë e Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe të shokëve të tij dhe të dijë si ishin ata, sepse pas tyre u shfaqën bidatet.

¹⁴ Transmeton Ahmedi nr.127, Ebu Daudi nr.4607, Tirmidhi nr.2676. Albani e ka cilësuar hasen Sahih në librin Sahih Ibn Maxheh Nr.40 dhe Darimiu në Sunenin e tij Nr.95.

Nga bidatet e para të cilat u shfaqën janë: bidati i hauarixhëve¹⁵, bidati i rafidive(shiave)¹⁶, pastaj bidati i mutezilive¹⁷, i kaderive¹⁸, etj. Në lidhje me këto bidate dhe bidatçin sahabët mbajtën qëndrim duke i urryer dhe duke u përpjekur për t'i ndryshuar ato. Është saktësuar në Sahihu Muslim (Nr.8) se Ibn Umeri kur mori vesh për shfaqjen e

¹⁵ Ky sekt u emërtua me këtë emër për shkak të rebelimit dhe kryengritjes ndaj Aliut duke refuzuar gjykimin. Ata quhen dhe me emërtime të tjera si p.sh.: Shekakijeh(dyshues) sepse i thanë Aliut: Dyshove ne vendimin tënd ndaj pranove të gjykoheste nga armiku yt. Quhen edhe Harurijeh sepse pasi që u shkëputën nga Aliu u tubuan në vendin e quajtur Harura. El Marikah(të dalurit) sepse dalin nga feja, siç ka ardhur në hadith. Quhen Neuasib që do të thotë ata që i vunë vetes si qëllim urrejtjen dhe armiqësinë e Aliut(Marrë me shkurtime nga libri “73 Grupet” 1/11).

¹⁶ Rafd do të thotë refuzim. U quajtën me këtë emër sepse refuzuan hilafetin e Ebu Bekrit dhe Umerit. Janë ata që ofendojnë dhe fyejnë shokët e Profetit *salAllahu alejhi ue selem*. (Marrë nga libri “Bedhlul mexhdhud fi ithbati mushabeheti er-rafidah bil jehud “1/85, Dhënia e mundit në vërtetimin e përngjasimit të madh që ekziston ndërmjet rafidive dhe çifutëve). Shejhul Islam ka thënë: Ky term për herë të parë në islam është shfaqur atëherë kur Zejd bin Alij Husejn doli i pasuar nga shiat, kur u pyet ç’mendonte në lidhje me Ebu Bekrin dhe Umerin, ai u përgjigj duke u lutur për ta për mëshirë dhe duke shprehur dashuri ndaj tyre, atëherë një pjesë e tyre e refuzuan atë. Ai tha: Më refuzuat, më refuzuat, që aty u emërtuan rafidah (Marrë nga libri Mexhmual Fetaua 13/53).

¹⁷ Mutezilitë që do të thotë braktisësit, janë pasuesit e Uasil bin Ata el Gazali, i cili braktisi mexhlinin e Hasen el Basrit. Uasili pretendonte se personi që kryen gjynah të madh nuk është besimtar dhe as nuk është kafir, por është një pozitë e ndërmjetme(e papërcaktuar). Kur dëgjuan Hasen el Basrin që nuk ishte dakort me ta, e braktisën mexhlinin e tij dhe që aty u quajtën mutezilij. (Marrë nga libri el Milel uen-nihal 1/38).

¹⁸ Kaderitë është emërtimi që ehlu suneti i kanë vënë një grupacioni që pretendojnë se ata i krijojnë veprimet e tyre dhe Allahu nuk ka të bëjë aspak në këtë çështje. Hedhin poshtë shefatin e Profetit *salAllahu alejhi ue selem* për gjynahqarët që të dalin nga zjarri, mohojnë shikimin e Allahut, dënimin e varrit, etj. Është transmetuar në disa ethere se kaderitë janë mexhusët e këtij umeti.

bidatit rreth kaderit i tha atij që i tregoi për këtë gjë: Kur t'i takosh ata njerëz (kaderitë) lajmëroji se unë jam larg prej tyre e ata janë larg prej meje, pastaj filloi tu transmetonte hadithin e Xhibrilit të cilin e kishte dëgjuar nga babai i tij.

Po ashtu Ali Ibn Ebi Talibi radijAllahu anhu mbajti qëndrim qortues dhe kritikues ndaj bidatit të haurixhëve, madje dërgoi tek ata djalnin e xhaxhait të tij, dijetarin e umetit (Ibn Abasin) i cili polemizoi dhe u bë shkak që të ktheheshin katërmijë nga ata, ndërsa një pjesë tjetër vazhduan në atë të tyre derisa i luftoi Aliu në betejën e Nahrauanit¹⁹.

Pra, kështu i shohim shokët e Profetit salAllahu alejhi ue selem që mbanin qëndrim ndaj bidateve që u shfaqën në kohën e tyre duke i urryer dhe kundërshtuar ato. Na e bën edhe më të qartë urrejtnen e tyre ndaj bidatçinjve hadithi i Ebu Umames në kapitullin e Sunetit në librin e Suneni Ebi Daudit, i cili kur i pa kokat e disa haurixhëve të kryqëzuar lajmëroi se ata janë krijesat më të këqija dhe janë qentë e zjarrit të xhehenemit²⁰.

Autori (imam Ahmed) tha : *Dhe të pasuarit e tyre (të marrësh ata për shembull).*

Shpjeguesi thotë: Dmth: të marrim sahabët për shembull dhe të besojmë se ata janë më të mirët e këtij umeti, më të dashurit tek Allahu, më të afruarit tek Ai. Allahu i Lartësuar

¹⁹ Shih librin "73 Grupet" 1/14.

²⁰ Transmeton Ahmed i nr 22213, Ibn Maxheh nr 176, Axhurri nr 63, e gjen dhe në librin Mishkatul Mesabih nr 3554, hadithi është hasen sipas verifikimit të Albanit në Sahihi Suneni Ibn Maxheh nr 164.

thotë: “Dhe kush e kundërshton të Dërguarin pasiqë i bëhet e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, e lëmë në atë që ka zgjedhur dhe e fusim në zjarr, sa vend i keq është ai”(Nisa 115).

Fjala e Tij: “dhe pason rrugë tjetër nga ajo e beimtarëve” ka për qëllim sahabët të cilët janë elita e këtij umeti, me besimin më të lartë dhe vlerën më të madhe tek Allahu, siç thotë Profeti salAllahu alejhi ue selem: “Sikur të shpenzojë ndonjëri prej jush flori sa mali i Uhudit nuk e arrin vlerën e shpenzimit të një grushti floriri të dhënë nga ata, bile as gjysmën e atij grushti”²¹.

Pra, në këtë ajet me fjalën “besimtarët” janë për qëllim shokët e Profetit salAllahu alejhi ue selem, prandaj kush ndjek rrugë tjetër veç rrugës së tyre ka dështuar me një dështim të hapur (të qartë). I mjafton këtij personi kërcënimi i Allahut për ta lënë atë në çfarë ka zgjedhur dhe për ta futur në xhehenem, e sa vend i keq është ai. E lusim Allahun të na ruajë.

Pra , është mëse e qartë se detyra e çdo nxënësi të dijes është të pasojë rrugën e besimtarëve dmth sahabëve dhe duhet ta përkujtojë e ta ketë parasysh këtë premtim nga Allahu. Me këtë rast le të analizojmë si shembull ilustrues thënien e dikujt prej ihuanëve:

*Vërtetë ihuanët kanë një kështjellë ku çdo gjë është e mirë.
Mos më pyet se kush e ndërtoi, dihet ai është el Bena Hasen.*

²¹ Transmeton Buhariu nr 3673 dhe Muslimi nr 2540.

Tani le të shohim programin që Hasen el Bena²² ka vendosur për hizbin (partinë) e tij, a është në përputhje me rrugën e sahabëve apo në kundërshtim me të?! Le ta analizojmë nga fillimi në fund, çfarë programi kishte në thirrjen e tij dhe metodologjinë e ndjekur?

A punoi për kritikimin dhe refuzimin e shirkut të madh që praktikohet në vendin e tij? Përgjigja është: Jo.

A punoi për kritikimin dhe refuzimin e bidateve, ku ndër bidatet më të rënda ishte ai i sufive²³ të cilët besojnë në panteizëm (në ekzistencën e njëhsuar)? A i kritikoi këta bidatçinj?!

Gjithashtu dhe në këtë rast përgjigjia është: Jo, sepse ai lavdëronte Muberginiun²⁴, sudanezin sufij i cili beson në panteizëm. Po ta analizojmë këtë menhexh, bidatet dhe shirkijatet që gjenden në të, shoh çështje që të shqetësojnë pa masë. Po ashtu nëse e analizojmë menhexhin e xhematit teblig²⁵, çfarë do gjejmë?! A mos ndoshta ata thërrasin për në

²² Hasen bin Ahmed bin Abdurrahman el Bena, themeluesi i xhematit Ihuanul Muslimin, i lindur në 1324Hixhri dhe vdekur në 1368 Hixhri. U rrit në Aleksandri dhe u arsimua në Kajro. Në përgjithësi thirrja e tij përqendrohet dhe bazohet në veprimtari të fshehtë të anëtarëve të saj. (Marrë nga libri el Islam 2/138 dhe Mu`xhemul muel-lifin 1/535).

²³ Quhen me këtë emër ngaqë vishnin rroba të leshta. Burimet kryesore të sufive janë: zbulesa, shijimi dhe ndjenja. çdo lloj nga këto burime ka nëndarjet e tij. (Marrë nga libri: el Mesadirur el ameh lit-telekk-ij indes-sufijeh fq.31).

²⁴ Muhamed bin Uthman el Muberginij, shejhu i tarikatis sufij. Kjo ligjëratë që përmban lavdërimin e këtij sufii është mbajtur nga Hasen el Bena në qendrën e ihuanëve në Kajro datë 9/6/1948. (Marrë nga libri Kafiletul ihuanil Muslimin 1/6259).

²⁵ Tebligët, xhemati i themeluar nga Muhamed bin Iljas el Kandehleuij i lindur në vitin 1302Hixhri dhe vdekur 1363Hixhri. Ky person pasonte

teuhid dhe e zbatojnë atë?! Përgjigjia: Jo, bile përkundrazi i kritikojnë ata që thërrasin për në teuhid. Të njëjtën analizë mund t'i bëjmë xhematit të sururive²⁶ të cilët e konsiderojnë të lejuar kryengritjen ndaj udhëheqësve muslimanë. Nëse meditojmë rreth këtyre metodologjive, në çfarë përfundimi do dalim: A janë ato në përputhje me rrugën e besimtarëve që është për qëllim rruga e sahabëve dhe çdokush që ecën në hapat e tyre, siç bënë as-habul hadith, prijësat në udhëzim me të cilët Allahu e ruajti fenë e Tij dhe Sunetin e Profetit salAllahu alejhi ue selem?!

Autori tha: *Dhe braktisja e bidateve.*

Shpjeguesi thotë: Duke qenë se lënia e bidateve është detyrë e çdo muslimani atëherë ndaj nxënësve të dijes dhe thirrësve tek Allahu është edhe më shumë obligim sepse lënia e bidateve është nga çëshjet me rëndësi të veçantë për

menhexhin Dijubendij, medhhebin hanefij, me akide esharije-maturidije dhe ndiqte tarikatin sufij. Ata kanë gjashtë baza që i quajnë gjashtë cilësitë, ato janë:

1. Vërtetimi i fjalës La ilahe il Allah.
2. Namazi me frikë dhe përuļje.
3. Mësimi i veprave të mira (jo e çështjeve të diturisë) dhe dhikri.
4. Respektimi dhe nderimi i Muslimianit.
5. Përmirësimi i nijetit.
6. Thirrja në rrugë të Allahut.

Secila nga këto cilësi ka një qëllim, një vlerë(mirësi) dhe mënyrë për ta arritur, të gjitha këto të përcaktuara në ndryshim me menhexhin e selefëve. (Marrë nga libri ed-Dauetu ilallah fq 75).

²⁶ Xhemati i sururive është pjellë e lindur nga ihuanul Muslimin. E morën këtë emër duke iu dedikuar të parit të tyre: Muhamed bin Surur, Zejnul Abidin. Studioi njëfarë kohë në Unejze të Arabisë Saudite por u dëbua si person i padëshirueshëm për këtë vend. Pas kësaj ai u vendos në shtetet e kufrit duke jetuar ndërmjet kafirave në Britani. Lëvizja e tij konsiderohet më tepër politike dhe e cila ka si qëllim luftën e hapur ideologjike me dijetarët dhe udhëheqësit Muslimanë.

muslimanin. Bidatet janë të shumta, si në kohët e hershme po ashtu edhe në kohët e mëvonshme. Ndër bidatet më të rrezikshme të kohës së sotme janë ato që po shihen në fushën e davetit nga bidatet e grupacioneve dhe partiakëve (hizbillëkut) të cilën Allahu e ka urreyer dhe e ka përbuzur në shumë ajete dhe ka urdhëruar që të jemi një umet i vetëm të bashkuar sepse feja jonë është një dhe adhurojmë Një Zot dhe pasojmë të njëjtin Profet, prandaj që të gjithë e kanë për detyrë që të largohen nga këto bidate të cilat e përçajnë umetin dhe e copëtojnë në grupe e parti, Allahu i Lartësuar thotë: “Ka ligjëruar për ju si fe, atë me të cilën e kishte urdhëruar Nuhun dhe atë që Ne ta shpallëm ty, si dhe atë me të cilën patëm urdhëruar Ibrahimin, Musain, Isain. Të praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Idhujtarëve u vjen e rëndë kjo tek e cila po i thërrisni. Allahu zgjedh kë të dojë dhe udhëzon drejt Tij atë që i kthehet Atij me pendim e nënshtrim” (Shura 13).

Ky ajet thekson se baza e fesë dhe ajo të cilën Allahu e ligjëroi për profetët më të dalluar (ulul azmi) bazohet mbi dy gjëra kryesore:

1. Njëhsimi i Allahut.
2. Bashkimi i umetit: “Ta praktikoni fenë dhe mos u përçani në të”.

Na lajmëroi se kjo është feja të cilën ua ka shpallur gjithë të dërguarve, ku në krye të tyre janë ulul azmi (pesë të zgjedhurit): Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe plotësohet numri i tyre me Profetin tonë Muhamedin salAllahu alejhim ue selem. Pra, përderisa të gjitha dërgesat, shpalljet janë bazuar mbi këto dy parime, kjo tregon se ato janë ndër obligimet më parësore dhe më të rëndësishme, ndaj Allahu i lartësuar thotë: “Me të vërtetë kjo feja juaj është një e vetme dhe unë

jam Zoti juaj, pra më adhuroni”(Enbija 92) dhe thotë: “Me të vërtetë kjo feja juaj është një e vetme dhe Unë jam Zoti juaj, pra jini të devotshëm ndaj meje”(Mu’minun 52).

Allahu në përshkrimin e disa njerëzve thotë: “E ata u ndanë në grupe, e copëtuan fenë dhe secili grup i gëzohet idesë së tij”(Mu’minun 53). Në këtë ajet Allahu i nënçmon dhe i përbuz partitë dhe grupimet dhe urdhëron për bashkim dhe mospërçarje në fe. Allahu i Lartësuar thotë: “Vërtetë ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në sekte e grupe, ti nuk ke aspak të bësh me ta. çështja e tyre i takon Allahut i Cili do i lajmërojë ata për çfarë vepronin”(Enam 159).

Ky është një kërcënim i madh për thirrësat e përçarjes, anëtarët e partive dhe grupacioneve, sidomos pas pastrimit që i bën Allahu Profetit salAllahu alejhi ue selem duke thënë: “Nuk ke të bësh aspak me ta”. Pra, le ta dimë se këto parti e sekte, janë të gjitha sëmundje dhe humbje, dhe se shpëtimi është vetëm në pasimin e Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe rrugës së halifeve të drejtë dhe veprës së sahabëve.

Autori tha: *Dhe çdo bidat është humbje.*

Shpjeguesi thotë: Është detyrë ta dimë se kërkohet nga çdo njeri, që ta pasojë të Dërguarin e Allahut salAllahu alejhi ue selem dhe t’i bindet atij sepse për këtë ka urdhëruar Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij: “Thuaj: bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit të Tij”(Nur 54) dhe: “çfarë tu japë i Dërguari merreni dhe çfarë tu ndalojë prej saj ndalohuni (jepini fund)”(Hashr 7) dhe: “Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të bëjë zgjedhje tjetër përveç asaj me të cilën ka

grykuar Allahu dhe i Dërguari i Tij”(Ahzab 36). Ti do pyetesh në varr dhe në Ditën e grykimit për pasimin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem dhe vërtetimin e lajmeve të tij dhe besimin në të, Allahu i Lartësuar thotë: “Do i marrim në llogari ata tek të cilët u dërguan profetët, do i pyesim edhe të dërguarit. Duke e ditur shumë mirë se çka ndodhur, Ne do tu tregojmë atyre për atë që punuan, sepse Ne nuk ishim që mungonim” (Araf 6-7)

Në hadithin e transmetuar prej Berra bin Azibit radijAllahu anhu thuhet: “ Kur të vendoset njeriu në varr dhe të largohen përcjellësit e tij, ai e dëgjon zhurmën e këmbëve të tyre. I vijnë atij dy engjëj, njëri quhet Nekir dhe tjetri Munker. E ulin atë dhe i thonë: Kush është Zoti yt? Kush është feja jote? çfarë di për atë person që u dërgua mes jush? Besimtarin e forcon Allahu për tu përgjigjur saktë: Zoti im është Allahu, feja ime është islami dhe Muhamedi salAllahu alejhi ue selem është Profeti im, i cili na erdhi me argumente dhe udhëzim, i besuam atij dhe e pasuam. Ndërsa kafiri dhe munafiku thotë: Ah, ah, nuk e di, i dëgjoja njerëzit që thonin diçka dhe e thoja sëbashku me ta. Atëherë goditet me një çekiç, që po të goditej me të një mal do e bënte pluhur atë, aty bërtet një britmë që e dëgjon çdo krijesë përveç xhinëve dhe njerëzve, e sikur ta dëgjonte xhini apo njeriu do vdiste (nga frika dhe tmerri)”²⁷.

Në hytben e ditës së Arafatit, Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “Dhe ju do pyeteni për mua, pra si do të përgjigjeni? Thanë: Dëshmojmë se e komunikuar shpalljen”²⁸.

²⁷ Transmeton Ahmedi nr 18559, Ebu Daudi nr 4753, Tajalisi nr 753. Hakimi nr 107 dhe e saktësoi atë. Hadithi është saktësuar nga Albani

²⁸ Transmeton Ebu Daudi nr 1905, Ibn Maxheh nr 3074, saktësoi Albani në Sahih suneni Ibn Maxheh nr 2494.

Duhet që njeriu i logjikshëm ta pyesë veten: A është duke pasuar atë të cilin Allahu e ka urdhëruar që të pasohet? Apo ndoshta po ndjek pasuesit e epsheve të cilët dëshirojnë ta humbin?!

Ajo me të cilën e porosis veten dhe ju është pasimi i Sunetit dhe lënia e bidateve sepse ato janë humbje dhe shkatërrim. Profeti salAllahu alejhi ue selem na e ka tërhequr vërejtjen nga bidatat, po ashtu kanë bërë edhe prijësat e udhëzuar, si p.sh. fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem: “Kush do jetojë nga ju do shohë kundërshtime të shumta prandaj kapuni për Sunetin tim dhe sunetin e halifëve të drejtë e të udhëzuar. Ruajuni, largohuni nga gjërat e shpikura sepse çdo gjë e shpikur është bidat dhe çdo bidat është humbje²⁹”, dhe fjala e tij: “Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj ajo është e refuzuar”³⁰.

Allahu i Lartësuar thotë: “Le të kenë kujdes ata të cilët kundërshtojnë urdhërin e tij (Profetit) se do t’i godasë ndonjë provë apo ndonjë dënim i dhimbshëm”(Nur 63).

Le ta dimë se të gjitha bidatat janë humbje, ndryshe nga ç’thonë disa: Ka bidat të mirë dhe të keq, apo bidati ndahet sipas pesë gjykimeve(haram, mekruh, vaxhib, e lejuar, e pëlqyer), por e sakta është e kundërta e fjalës së tyre³¹ sepse

²⁹ Transmeton Muslimi

³⁰ Transmeton Buhariu 2/100, Muslimi nr 1718

³¹ Sh.p:Për më tepër shiko rreth kësaj çështjeje në librin: Qëndrimi i ehlu Sunetit dhe xhematit ndaj bidatçinjve dhe pasuesve të tekave, të shejkhut Ibrahim Ruhejli, ku në një nga kapitujt e tij trajtohet pretendimi i atyre që e klasifikojnë bidatin në të mirë dhe të keq apo në

diçkaje i thuhet bidat nëse ka të bëjë me fenë, ndërsa çfarë është në lidhje me çështjet e dunjasë nuk i thuhet bidat(në terminologjinë e sheriatit).

Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë në lidhje me shumimin vegjetativ të hurmës: “Ju i dini më mirë punët tuaja të dunjasë³²”. Pra, nuk i thuhet bidat përdorimit të gjërave të reja në çështjet e dunjasë, por ajo konsiderohet përpjekje për arritjen e gjërave të dobishme, ndërsa bidat i thuhet asaj çfarë shpiket si ibadet në fe.

Autori tha: *Largimi nga polemikat dhe nga ulja me pasuesit e tekave, largimi nga debatet, polemikat dhe kundërshtimet në fe.*

Shpjeguesi thotë: Argumenti i kësaj është fjala e Allahut: “Juve është shpallur në këtë Libër se kur të dëgjoni që ajetet e Allahut po mohohen ose përqeshen, atëherë mos rrini me ata njerëz, derisa të ndërrojnë bisedë. Nëse vazhdoni të rrini me ta, ju do jeni njësoj si ata”(Nisa 140).

Në hadithin e saktë Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush dëgjon për daljen e Dexhalit le të largohet prej tij sa të mundet, sepse ai do i vijë personit i cili e mendon veten besimtar dhe do vazhdojë t’i hedhë dyshime derisa ta bëjë për vete”³³.

Imam Ibn Betah në lidhje me këtë hadith ka thënë: Kjo është thënia e Profetit salAllahu alejhi ue selem i cili është i vërteti

ndarjen sipas pesë dispozitave, duke i hedhur poshtë me argumente të qarta dhe të padiskutueshme.

³² Transmeton Muslimi nr 2363

³³ Transmeton Ahmedi, Ebu Daudi, saktësoi Albani.

dhe i besueshmi, duke i tërhequr vërejtjen muslimanëve që të mos mashtrohet dikush me veten e tij nga fakti që është në drejtim të saktë dhe t'ia lejojë vetes që të rrezikojë me fenë e tij duke u shoqëruar me ndonjë bidatçi (pasues të ideve të devijuara). Ky person (i mashtruar) thotë: Unë po hyj e dal tek ai që të polemizoj me të dhe ta largoj nga devijimi i tij. Mos ta bëjë diçka të tillë sepse fitneja e bidatçinjve është më e rrezikshme se e Dexhalit, fjala e tyre është më ngjitëse sesa zgjebja, i djeg zemrat më shumë se sa flaka e zjarrit. Kam parë ca njerëz të cilët i shanin bidatçinjtë, pastaj filluan të uleshin me ta me pretendimin për tua kundërshtuar dhe ndryshuar gabimet, por vazhduan në këtë lloj gjendjeje pa e kuptuar mashtrimin dhe kufrin e fshehtë, derisa i futën në të³⁴.

Erdhi një person tek Enesi radijAllahu anhu dhe i tha: O Ebu Hamza, kam takuar ca njerëz të cilët e mohojnë ndërmjetësimin dhe dënimin e varrit, tha: Ata janë gënjeshtarët, përgënjeshtresit, prandaj mos u ul me ta.

Ibn Abasi ka thënë: Mos u ul me pasuesit e epsheve sepse ulja me ta është sëmundje për zemrat.

Ebul Xheuza një nga tabiinët e mëdhenj ka thënë; Që të kem komshinj derrat dhe majmunët është më e dashur për mua se sa të kem komshinj ndonjë prej tyre (bidatçinjve).

Ka thënë Fudejl ibn Ijad: Mos u ul me një person që ka bidate sepse kam frikë se do të zbresë mbi ty mallkimi.

Hynë tek Ibn Sirini dy persona nga pasuesit e tekave dhe thanë: O Ebu Bekër, duam të të tregojmë një hadith. Tha: Jo. Thanë: Atëherë të të lexojmë një ajet nga Libri i Allahut. Tha: Jo, ose ngrihuni ose do ngrihem unë. Pasiqë ata dolën, dikush

³⁴ Transmetohet në El Ibaneh 2/480.

i tha: O Ebu Bekër, çfarë do të të kishte dëmtuar nëse do të lexonin një ajet nga Kurani? Tha: Kisha frikë se mos e lexonte ajetin dhe e shtrembëronte atë dhe ngelej ashtu në zemrën time.

AbduRrezaku ka thënë: Më ka thënë mua Ibrahim bin Muhamed bin Ebi Jahja: Po shoh se tek ju ka shumë mutezilinj. Thashë: Po, bile ata pretendojnë se edhe ti je me ta. Tha: A po vjen me mua të hyjmë në shtëpi dhe të bisedojmë. Thashë: Jo. Tha: Pse? Thashë: Sepse zemra është e dobët dhe feja nuk është sipas atij që mund tjetrin në debat.

Mubeshir ibn Ismail el Halebi tha: I thanë Euzaiut: Është një person i cili thotë: Unë ulem me ehlu sunetin, ulem dhe me bidatçinjtë. Euzai tha: Ky është person i cili dëshiron të bashkojë mes të vërtetës dhe të kotës.

Hasan el Basri i tha një personi që i kërkoi të polemizonte me të: Unë e njoh fenë time, nëse ti e ke humbur fenë tënde shko kërkije³⁵.

Pasuesit e bidateve dhe tekave kanë disa shenja me të cilat mund t'i dallojmë:

1. Të përmendurit për keq dhe ofendimi i pasuesve të transmetimeve dhe gjurmëve (ehlul ether). Ebu Hatim err-Rrazi ka thënë: Shenjë dalluese e bidatçinjve është të folurit keq për pasuesit e gjurmëve dhe transmetimeve (ehlul ether, ehlu hadith)³⁶.

³⁵ Transmeton el Axhurri në esh-Sheriah nr 57 dhe el-Lalekai nr 215

³⁶ Sh.p:Në një thënie tjetër Ebu Hatimi thotë: Shenja e zindikëve është emërtimi i ehlu sunetit Hasheuije(grumbullues të çdo gjëje), duke pasur si qëllim zhvlerësimin e transmetimeve

2. Armiqësia ndaj ehlul hadithit (dijetarët e hadithit dhe pasuesit e tyre) dhe heshtja e tyre ndaj pasuesve të humbjes dhe të kotës. Profeti salallahu alejhi ue selem në përshkrimin e hauarixhëve ka thënë: “Ata janë që vrasin muslimanët dhe i lënë idhujtarët”³⁷. Ebu Uthman es-Sabuni ka thënë: Shenjat që bidatet lënë tek bidatçinjtë janë të dukshme dhe të qarta, ndër shenjat më dalluese të tyre është armiqësia e ashpër për ata që bartin transmetimet e Profetit, nënçmimi që u bëjnë atyre, cilësimi i tyre me nofka e llagape si: hasheuijeh (grumbullues të çdo gjëje), injorantë që s’kuptojnë, sipërfaqësorë, përngjasues, kjo sepse ata (bidatçinjtë) i shohin lajmet e Profetit larg diturisë³⁸ dhe se dituria (sipas tyre) është çfarë ju shpall atyre shejtani, përfundimet e mendjeve të tyre të prishura, iluzionet e shpirtrave të tyre të errët, ndenjat e zemrave të tyre të zbrazura nga hajri dhe argumentet e tyre të kota, këta janë të cilët Allahu i ka mallkuar.
3. Kërkimi i ndihmës nga udhëheqësit dhe sundimtarët kundra ehlu sunetit dhe kjo për shkak të dobësisë së argumenteve që kanë bidatçinjtë, kjo është rruga e tyre dhe ndër zgjidhjet e tyre të pakta. Pra, kërkojnë ndihmë nga sundimtarët për të ndihmuar thirrjen e tyre duke përdorur një lloj detyrimi dhe frikësimi³⁹.

³⁷ Transmeton Buhariu nr 7432 dhe Muslimi nr 1064.

³⁸ Sh. p: Siç është shprehja e esharijve: Medhhebi i selefëve është më i ruajtur (më i sigurtë) kurse ne jemi më të ditur dhe më preçiz

³⁹ Sh. p: Siç ndodhi në kohën e imam Ahmedit apo siç bëjnë edhe sot.

4. Shtimi i tepërt në ibadet dhe kalimi i kufinjve. Bidatçiu shton në ibadet për të arritur lavdërim në dunja, pozitë, pasuri dhe interesa të tjera. Pra, kërkon të arrijë pozitë dhe lavdërim duke u shkëputur nga dëshirat e dunjasë. A nuk e sheh se si murgjit u mbyllën në manastire duke u shkëputur nga çdo kënaqësi dhe shtimi i tyre në llojet e ndryshme të ibadeteve, e megjithatë janë në zjarr përgjithmonë, Allahu i Lartësuar thotë: “Atë ditë do ketë fytyra të frikësuarra (të përulura). Që kanë punuar e janë lodhur, do hyjnë në zjarrin e ndezur fort”(Gashijeh 2-4) dhe thotë: “Thuaj: A t`u tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre? Janë ata të cilët veprat e tyre u asgjësuan që në jetën e kësaj bote e megjithatë ata mendojnë se janë duke bërë mirë”(Kehf 103-104). Kjo sepse përkushtimi i tyre në ibadet është sipërfaqësor dhe gjallëri e rreme (e shtirur) me të cilën mundohen të përballojnë vështirësitë, kjo për shkak të tekave që kanë në vetet e tyre. Bidatçiu e sheh drejtimin e tij si të dashur e të saktë prandaj vazhdon të kapet pas tij dhe të përparojë në të duke i parë veprat e tij më të mira se veprat e të tjerëve dhe besimin e tij si më të saktin: “Kështu Allahu e humb kë të dojë”(Mudethir 31).

Dikush mund të mashtrohet nga bidatçinjtë kur i sheh ata që shfaqen në mënyrë të shtirur si modestë, zahida(moslakmues në dunja), të devotshëm, duke qarë, ibadet të shumtë por nuk është ky kriteri përcaktues me të cilin njihet e vërteta.

Profeti salAllahu alejhi ue selem u tha shokëve të tij në përshkrimin e havarixhëve: “E nënçmoni namazin tuaj në krahasim me namazin e tyre dhe agjërimin tuaj në krahasim me agjërimin e tyre dhe leximin tuaj (të Kuranit) në krahasim me leximin e tyre”⁴⁰.

Ndërsa përsa i përket disa nga shenjave më dalluese të ehlu sunetit janë:

Së pari: Thirrja e tyre për tek Libri i Allahut, për ta pasuar dhe punuar me të.

Së dyti: Komenti që i bëjnë Kuranit me gjurmët e transmetuara, pra me Sunetin dhe komentin e sahabëve dhe tabiinëve.

Së treti: Thirrja për tek Suneti i saktë i transmetuar nga Profeti salAllahu alejhi ue selem .

Së katërti: Besimi i tyre se Suneti është sqarues dhe komentues i Kuranit.

Së pesti: Dashuria për Sunetin, për pasuesit e tij, për bartësit e tij. Të besuarit se me ta (dijetarët e hadithit) Allahu e ka ruajtur fenë. Allahu i ka zbukuruar zemrat e ehlu sunetit dhe i ka ndriçuar me dashurinë për dijetarët e sunetit, kjo është mirësi nga i Lartësuari. I thanë Ebu Bekër ibn Ajashit: Kush është sunij (pasues i sunetit)? Tha: Ai, tek i cili nëse flitet kundra tekave (bidateve) nuk zemërohet për këtë.

⁴⁰ Transmeton Buhariu nr 6933 Muslimi nr 2447.

Së gjashti: Qëndrimi i mesëm i tyre, as teprim e as mangësim, as neglizhencë e as ekstremizëm.

Së shtati: Nuk e teprojnë në dashurinë dhe konsideratën për ndonjë nga prijësat e tyre fetarë sa që të besojnë se ai është i pagabueshëm, qoftë ai nga sahabët apo të tjerët pas tyre.

Së teti: I urrejnë bidatçinjtë dhe e konsiderojnë ibadet luftimin e tyre (me dituri), qartësimin e gjendjes dhe bidateve të tyre ashtu që të ruhen njerëzit prej tyre dhe bidateve që mbartin.

Së nënti: Kujdesi dhe rëndësia që i kushtojnë akides dhe dhënia përparësi asaj ndaj veprave të tjera, ndryshe nga ajo çfarë bëjnë bidatçinjtë.

Autori tha: 1) *Suneti tek ne janë transmetimet e Profetit salAllahu alejhi ue selem .*

2) Suneti e komenton Kuranin dhe është udhëzues për tek ai.

Shpjeguesi thotë: 1) Kur thuhet: Gjurmët e Profetit është për qëllim: çdo gjë që është transmetuar nga ai, qofshin fjalë apo vepra apo miratime (aprovime).

2) Argument i kësaj është fjala e Allahut: “Dhe ta zbritëm ty Përkujtimin që t`u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, në mënyrë që të mendojnë”(Nahl 44), dhe thotë: “Ai është i Cili u dërgoi arabëve analfabetë Profet nga vetë mesi i tyre që t`u lexojë ajetet e Tij, t`i pastrojë ata (nga papastërtia e mosbesimit) dhe tua mësojë Librin (Kuranin) dhe urtësinë

(Sunetin) duke qenë se më parë ata ishin në humbje të qartë”(Xhumua 2).

Libri i përmendur në ajet është Kurani, ndërsa urtësia është Suneti.

Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Me të vërtetë mua më është dhënë Kurani, po ashtu edhe një herë aq sa ai”⁴¹.

Allahu e ka urdhëruar të dërguarin e Tij që t’u sqarojë njerëzve atë që u është shpallur në Libër, p.sh: Namazi është obliguar në Kuran në mënyrë të përgjithshme ndërsa Suneti e bëri të qartë numrin e namazeve, kohët e tyre, çfarë është farz dhe çfarë është nafile, pastrimin që është detyrë para faljes, etj, po kështu themi për zekatin, etj.

Autori tha: 1) *Nuk bëhen krahasime në Sunet.*

2) *Nuk jepen shembuj për ta kundërshtuar atë. Nuk është kusht që ta kuptojë mendja e njeriut apo tekat e tij, përkundrazi është pasim(i Sunetit) dhe largim nga tekat.*

Shpjeguesi thotë: 1) Qëllimi i autorit është: Nuk bëhen krahasime në Akide dhe tekstet që kanë të bëjnë me çështjet e akides, sepse këtu nuk ka vend për krahasime (kijas) sepse krahasimi hyn vetëm në çështjet e fikhut (ritet fetare dhe adhurimet).

2) Ebu Hurejra po tregonte një hadith nga Profeti salAllahu alejhi ue selem në lidhje me abdesin pasi të kesh ngrënë diçka të gatuar në zjarr, një sahabij i tha Ebu Hurejres: A nuk po i urdhëron njerëzit të marrin abdes edhe nga uji i nxehtë?!

⁴¹ Transmeton Ahmed i nr 17174, Ebu Daudi nr 4604, saktësoi zinxhirin e tij Albani në el Mishkah 1/58.

Tha: O djali i vëllaut tim, kur të të them një hadith nga Profeti salAllahu alejhi ue selem mos hidh shembuj kundra tij.

E rëndësishme në këtë pikë është ta dimë se ka për qëllim që të mos jepen shembuj ndaj Sunetit kur kemi të bëjmë me bazat e akides. Profeti salAllahu alejhi ue selem e qortoi Hamele ibn Nabigah kur tha: Si të dëmshpërblej për dikë që as nuk hëngri e as nuk piu, as nuk foli e as nuk klithi, një i tillë nuk merret parasysh! Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “A po bën rimë (poezi) si rima e magjistarëve”, në një transmetim tjetër: “Me të vërtetë ky është nga vëllezërit e magjistarëve për shkak të kësaj rime që bëri”⁴².

Prandaj nuk lejohen të jepen shembuj ndaj Sunetit me qëllim për të mos punuar me të dhe për ta hedhur poshtë, sepse detyra e robit është që kur të dëgjojë një hadith të saktë (me zinxhir të saktë) ta besojë dhe vërtetojë atë, e jo të nxjerrë shembuj për ta hedhur poshtë atë Sunet apo për ta kundërshtuar me logjikë, përkundrazi e ka detyrë ta besojë edhe nëse bie ndesh me logjikën e tij. P.sh: hadithi të cilin e transmeton Buhariu nga Ebu Hurejra radijAllahu anhu se Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “Erdhi meleku i vdekjes tek Musa ibn Imrani dhe i tha atij: Përgjigju Zotit tënd. Musai e goditi me shpullë melekun e vdekjes duke ia nxjerrë syrin. U kthye meleku tek Allahu dhe tha: Më ke dërguar tek një rob i Yti i cili nuk e dëshiron vdekjen dhe më ka nxjerrë syrin. Allahu ia riktheu syrin dhe tha: Kthehu përsëri tek robi Im dhe i thuaj: A dëshiron të jetosh gjatë? Nëse dëshiron jetën e kësaj dunjaje vendose dorën tënde mbi kurrizin e një kau dhe

⁴² Transmeton Buhariu nr 5758 dhe Muslimi nr 36.

për çdo qime që do prekësh do jetosh një vit. Musai tha: Po më pas? Tha: Pastaj do vdesësh. Tha: Nëse është kështu atëherë më mirë të vdes tani. O Zoti im më bëj të vdes afër tokës së shenjtë me afërsi sa hedhja e gurit. Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “Pasha Allahun Sikur të isha tani atje do ua tregoja varrin e tij anës rrugës tek duna e kuqe”⁴³.

Disa njerëz e shohin këtë si të pamundur, mendjet e tyre nuk e pranojnë diçka të tillë, biles e përgënjeshtrojnë atë megjithëse është hadith i saktë. Nuk i lejohet asnjë muslimani që ta përgënjeshtrojë diçka të ngjashme.

Autori tha: *Nga sunetet e obligueshme të cilat kush e lë një prej tyre -duke mos e pranuar dhe mos besuar në të- nuk është nga pasuesit e sunetit janë:*

Shpjeguesi thotë: “Nga Suneti” ka për qëllim rrugën dhe metodologjinë (menhexhin).

Dijeni se fjala Sunet ka dy kuptime:

Kuptimi i parë :është për qëllim rruga dhe menhexhi në të cilin ka ecur Profeti salAllahu alejhi ue selem dhe shokët e tij. Këtu përfshihet vaxhibi (e obligueshmja) dhe mustehabi (e pëlqyeshmja). Kur thuhet kjo gjë është nga Suneti, përfshin vaxhibin si p.sh: lëshimi i mjekrës, ngritja e rrobës mbi nyje të këmbës si dhe përfshin (mendubin) të pëlqyeshmen si p.sh: dhënia dhe marrja me dorën e djathtë.

Kuptimi i dytë: Me fjalën sunet fukahatë kanë për qëllim atë ibadet që është në gradë më të ulët se vaxhibi si p.sh: hadithi:

⁴³Transmeton Buhariu nr 3407 dhe Muslimi nr 6100.

“I pëlqente (Profetit salAllahu alejhi ue selem) dhënia përparësi të djathtës në veshjen e nallaneve, në të krehur, në pastrim dhe në të gjitha çështjet e tjera”⁴⁴. Pra kuptimi i kësaj është pëlqyeshmëria, ndaj dhe thuhet: Të filluarit me të djathtën është e pëlqyeshme.

Autori tha: *Të besuarit në kader (paracaktimin), të mirën dhe të keqen e tij, vërtetimi i haditheve që janë transmetuar në lidhje me të dhe besimi në to. Nuk thuhet “Pse”, “Si”, por është besim dhe vërtetim i tyre. Kush nuk e di komentin e një hadithi apo që mendja e tij nuk arrin ta kuptojë le ta dijë se ka të tjerë që e kanë kuptuar drejtë dhe që i kanë dhënë koment prandaj nuk ngelet tjetër veçse besimi në kader dhe pranimi i tij.*

Shpjeguesi thotë: Dijeni se kaderi është ajo çfarë ka paracaktuar Allahu për robërit e Tij, mirësi qoftë apo e keqe, besim apo kufr, lumturi apo fatkeqësi, pasuri apo varfëri, shëndet apo sëmundje, e çështje të tjera të cilat i ka caktuar Allahu për robërit.

Këtë gjë e vërteton hadithi i saktë ku Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Gjëja e parë të cilën Allahu e ka krijuar është lapsi pastaj i tha atij: Shkruaj dhe që nga ai moment u shkruajt çdo gjë që do të ndodhë dhe ekzistojë deri në Ditën e Gjykimit”⁴⁵, gjithashtu në hadithin tjetër: “Allahu i ka shkruar caktimet e çdo gjëje para se të krijojë qiejt dhe tokën me 50.000 vjet dhe Arshi i Tij ishte mbi ujë”⁴⁶.

Po ashtu në hadithin tjetër: Sahabët thanë: O Rasulullah: Kjo që ne veprojmë a është diçka e re apo është diçka e

⁴⁴ Transmeton Buhariu nr 5854 dhe Muslimi 268.

⁴⁵ Transmeton Buhariu nr 5854 dhe Muslimi nr 268

⁴⁶ Transmeton Tirmidhiu nr 3319, Axhurri nr 385, Ibn Ebi Asimi nr 104.
Saktësoi zinxhirin e tij Albani në Dhilalul xheneh 1/48

përcaktuar që më parë? Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “Është diçka e përcaktuar që më parë. Sahabët thanë: A ta lëmë punën dhe t'i mbështetemi asaj që është shkruar? Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “Punoni, sepse secilit do i lehtësohet ajo për të cilën është krijuar”⁴⁷.

Pra, është detyrë besimi në kader dhe pranimi i tij, madje kush nuk beson në kader nuk ka pjesë në islam, siç ka ardhur në hadithin e Ibn Umerit ku Jahja ibn Jamer thotë: I pari që foli rreth kaderit ishte Ma`bed el Xhuhenij në Basra. U nisa unë dhe Humejd ibn AbduRrahman el Himjeri për në Haxh ose Umre dhe thamë: Ah, sikur të arrinim të takonim ndonjë nga shokët e Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe ta pyesim për atë çfarë thonë këta njerëz rreth kaderit. Na u bë e mundur të takonim Abdullah Ibn Umer ibn Hatabin radijAllahu anhumu kur ai po hynte në xhami dhe unë me shokun tim e rrethuan nga të dyja anët, njëri nga e djathta dhe tjetri nga e majta. Duke besuar se shoku im do ma linte rradhën për të folur thashë: O Ebu Abdu Rrahman! Janë shfaqur tek ne ca njerëz të cilët e lexojnë Kuranin dhe e kërkojnë diturinë –dhe përmendi disa cilësi të tyre– por ata pretendojnë se nuk ka kader (paracaktim) dhe se çfarë ndodh është e re. (Ibn Umeri) Tha: Kur t'i takosh ata persona bëjua të ditur se unë jam larg prej tyre dhe ata janë larg prej meje. Abdullah Ibn Umeri betohet se edhe sikur të kishte ndonjëri prej tyre flori sa mali i Uhudit dhe t'i jepte (sadaka), Allahu nuk do t'i pranonte asgjë derisa të besojnë në kader” pastaj përmendi hadithin që e transmeton Umeri radijAllahu anhu

⁴⁷ Transmeton Ahmedi 1/2906, Tirmidhiu nr 2135 dhe e saktësoi atë.

në lidhje me ardhjen e Xhibrilit tek Profeti salAllahu alejhi ue selem ⁴⁸.

Kështu pra Ibn Umeri e konsideroi veten larg atyre që mohuan kaderin. Këto hadithe të sakta e kemi detyrë t'i besojmë dhe t'i vërtetojmë bindshëm pa asnjë lloj dyshimi në përmbajtjen e tyre.

Pas kësaj duhet ta dini se ata të cilët devijuan në çështjen e kaderit janë dy grupe:

Grupi i parë: Mohuesit e tij, të cilët thonë se nuk ka kader dhe pretendojnë se robi i krijon vetë veprat e veta.(Të cilët quhen Kaderijeh).

Grupi i dytë: Ata të cilët e teprojnë në pohimin e kaderit duke pretenduar se robi është i imponuar (pa liri zgjedhjeje) në kryerjen e veprimeve të tij. (Të cilët quhen Xhebrijeh).

Të dyja këto janë bidat dhe ekstremizëm dhe e vërteta është e mesmja e këtyre dyjave, pra besimi i grupit të shpëtuar të cilët thonë: Besojmë në kader dhe besojmë se robi ka liri zgjedhjeje dhe se shpërblimi për veprat i kthehet atij sepse Allahu e ka vërtetuar diçka të tillë duke thënë: “Për atë nga ju i cili dëshiron t'i përmbahet rrugës së drejtë, por ju nuk mund të dëshironi vetëm nëse do Allahu Zoti i botërave”(Tekuir 28-29). Kjo liri zgjedhjeje nuk mund të dalë jashtë asaj që ka paracaktuar Allahu. Këtë gjë e vërteton gjithashtu fjala e Tij: “Pasha nefsin (Ademin ose llojin e njeriut) dhe pasha Atë i Cili e krijoi atë, pastaj i tregoi se çfarë është e dëmshme (e gabuar) dhe çfarë është e mirë për të”(Shems 7-8) e shumë

⁴⁸ Transmeton Muslimi nr 8.

ajete të tjera. Pas kësaj duhet ta dimë se të dy grupet ekstremiste janë të humbura si: kaderijet mohues ashtu edhe xhebrijet imponues.

Autori tha: *Si p.sh: hadithi i të Sinqertit, të besueshmit(ai që flet të vërtetën dhe që është i vërtetuar)⁴⁹ apo hadithe të ngjashme rreth kaderit apo hadithet rreth shikimit të Allahut në Ahiret edhe nëse nuk tingëllojnë bukur në të dëgjuar apo nuk i pëlqejnë dëgjuesit.*

Shpjeguesi thotë: Ka për qëllim hadithin e Ibn Mesudit radijAllahu anhu i cili tha: Na tha ne Profeti salAllahu alejhi ue selem, i cili është i sinqerti dhe i besueshmi: “Me të vërtetë robi formohet në barkun e nënës së tij duke qenë dyzet ditë pikë lëngu, pastaj copë gjaku për një kohë të njëjtë, pastaj si copë mishi për një kohë të njëjtë, pastaj dërgohet engjëlli dhe i fryn në të shpirtin dhe i shkruan rrizkun (furnizimin) e tij, veprat e tij, jetëgjatësinë e tij dhe nëse do të jetë fatlum apo fatkeq”⁵⁰.

Kaderi është i shkruar në Leuhi Mahfudh siç u përmend në një hadith të mëparshëm. Gjëja e parë të cilën Allahu krijoi është lapsi dhe i tha atij: Shkruaj dhe që nga ai moment u shkruajt çdo gjë që do ndodhë dhe ekzistojë deri Ditën e Gjykimit”⁵¹, Allahu i Lartësuar thotë: “Ne çdo gjë e kemi krijuar me kader (me paracaktim dhe masë të përcaktuar)” (Kamer 49).

⁴⁹ Sh.p: Me këtë emër njihet hadithi që flet për shkrimin e katër gjërave që në barkun e nënës

⁵⁰ Transmeton Buhariu nr 3332 dhe Muslimi nr 2643.

⁵¹ Transmeton Buhariu nr 5854 dhe Muslimi nr 268 .

Pra, Allahu ka shkruar në Leuhi Mahfudh përcaktimet e çdo gjëje që para se të krijonte qiejt dhe tokën, ka përcaktuar paaftësinë, aftësinë, shkathtësinë dhe çdo gjë tjetër, ndaj e kemi detyrë që të besojmë në të. Siç është transmetuar se: “Engjëjt e nderuar shkrues qëndrojnë me robërit dhe shkruajnë çdo gjë që ata bëjnë, pastaj kthehen në qiell dhe vështrojnë në Leuhi Mahfudh dhe e gjejnë të përputhur plotësisht atë që ata kanë shkruar me atë që është e shkruar në Leuhi Mahfudh, qoftë e mirë për ta (njerëzit) apo kundra tyre. Këto shkrime i paraqiten Allahut çdo të hënë dhe të enjte dhe Allahu fshin prej tyre ato gjëra për të cilat nuk ka shpërblim e as dënim, si psh: thënia e personit: Zbrite samarin, ma jep enën, më jep ujë, etj. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Allahu fshin (nga ajo evidencë) çfarë të dojë dhe përforcon në të çfarë të dojë dhe tek Ai është është Libri bazë”(Rrad 39). Transmeton diçka të ngjashme Ibn Xheriri në tefsirin e tij.

Ky është ai i cili quhet përcaktimi i hershëm, pastaj vjen përcaktimi jetësor i cili u përmend në hadithin e Ibn Mesudit që e thamë më herët, pastaj vjen përcaktimi vjetor i cili bëhet natën e Kadrit kur engjëjt shkruajnë çdo gjë që do të ndodhë gjatë atij viti dhe ky shkrim është një lloj realizimi i asaj që është shkruar në përcaktimin e hershëm. Pastaj vjen përcaktimi ditor i cili është shkrimi i engjëjve të asaj çfarë bëjnë robërit në ditën e tyre, po ashtu edhe ky konsiderohet një lloj realizimi i përcaktimit të hershëm. Duke u nisur nga e gjithë kjo mund të themi se përcaktimi është katër llojesh:

1. Përcaktimi i hershëm i cili u përmend në hadithin e lapsit.
2. Përcaktimi jetësor i cili u përmend në hadithin e Ibn Mesudit.
3. Përcaktimi vjetor i cili bëhet natën e Kadrit.
4. Përcaktimi ditor i cili është shkrimi i engjëjve në fletushkat e secilit peson.

Tre të fundit janë të marra (si rrjedhojë) nga i pari dhe nuk mund të konsiderohet i saktë besimi i robit derisa t'i besojë këto të gjitha pa asnjë dyshim. Në hadithin e Umerit radijAllahu anhu në lidhje me ardhjen e Xhibrilit, Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Dhe të besosh në kader, në të mirën dhe të keqen e tij”.

Autori tha: *Pra, detyrë e robit është t'i besojë ato (hadithet) dhe të mos refuzojë asnjë shkronjë të tyre apo të çdo hadithi që transmetohet nga transmetuesit e besueshëm. Po ashtu nuk i takon të polemizojë as të debatojë e as t'i mësojë polemikat. Të folurit (me të kotë dhe pa dije) rreth kaderit, shikimit të Allahut në Ahiret, Kuranit apo gjëra të tjera nga Suneti si këto, është e urryer dhe e ndaluar dhe nuk mund të jetë ky person nga ehlu suneti edhe nëse rastësisht ia qëllon me fjalën e tij të vërtetës, derisa ta lërë polemikën, t'ia dorëzojë çështjen Allahut dhe t'u besojë transmetimeve.*

Shpjeguesi thotë: Është e ndaluar të polemizohet rreth kaderit sepse kaderi është një e fshehtë nga të fshehtat të cilat i di vetëm Allahu dhe nuk mund ta dijë askush se çfarë është e paracaktuar përveç Allahut, ndaj nuk na lejohet refuzimi apo kritikimi apo polemizimi në këtë çështje, sepse polemika në të nuk nxjerr asnjë rezultat të dobishëm,

përkundrazi mund të sjellë rezultate të dëmshme: futjen e dyshimeve tek robi. Pra, duhet ta dish se detyra jote është që të mos polemizosh në kader apo të debatosh rreth tij, e gjitha kjo është në dobinë tënde sepse nëse do i dëgjosh dyshimet të cilat i hedh bidatçiu, ndoshta diçka prej tyre do hyjë në zemrën tënde dhe do zërë vend aty duke të shndërruar në dyshues pasiqë ishe i bindur dhe besimtar i qëndrueshëm. Pra, kije frikë Allahun në veten tënde, përpiqu t`u largohesh këtyre gabimeve që thamë sepse janë pista të rrëshqitshme dhe shkatërruese.

Transmetohet në Sahihul Buhari se Profeti salAllahu alejhi ue selem doli tek shokët e tij kur ata po polemizonin rreth Kuranit dhe u zemërua shumë saqë dukej në fytyrë si të ishte frut shege i hapur (nga brenda) dhe tha: “A me këtë gjë jeni urdhëruar?!”⁵².

Autori tha: *Kurani është fjala e Allahut dhe nuk është i krijuar dhe mos të ndjesh dobësi që të thuash se nuk është i krijuar, sepse fjala e Allahut është cilësi prej cilësive të Tij, nuk është e ndarë prej Tij dhe nuk ka gjë të krijuar në Të, asnjë cilësi e Tij nuk është e krijuar. Mos polemizo me ata që shpikën në këtë çështje dhe që shfaqën çështjen e “të shprehurit” (të lexuarit) e të tjera, kush heziton në këtë çështje dhe thotë: Nuk e di a është i krijuar apo jo, por është fjala e Allahut, ky person është bidatçi njëlloj si ai i cili thotë: Ai është i krijuar. Pra (e vërteta është të thuhet): Ai është fjala e Allahut dhe nuk është i krijuar.*

Shpjeguesi thotë: Allahu e ka quajtur Kuranin fjalë të Tijën duke thënë: “E nëse ndokush nga idhujtarët kërkon strehim

⁵² Transmeton Ahmedî nr 6680, Ibn Maxheh nr 85, Buhariu në librin Halku efalil ibad nr 43, Begauî nr 121, e ka bërë hasen Albani nr 98.

tek ti, atëherë strehoje me qëllim që ai të dëgjojë fjalën e Allahut (Kuranin) dhe pastaj përcille deri në vendin e tij ku ndihet i sigurtë. Kjo sepse ata janë njerëz që nuk dinë”(Teube 6) dhe thotë: “Atij i përket krijimi dhe urdhërimi”(Araf 54).

Ibn Ujejneh ka thënë: Krijimi i përket vetëm Allahut ndërsa me urdhërimin është për qëllim Kurani.

Umeri radijAllahu anhu ka thënë: Kurani është fjala e Allahut prandaj mos e lakoni sipas mendimeve dhe tekave tuaja.

Maliku ka thënë: Kurani është fjala e Allahut dhe urrehet mendimi i atyre që thanë: Kurani është i krijuar. Po ashtu Maliku thotë: Ky person (që thotë këtë fjalë) goditet, rrihet dhe burgoset deri në vdekje.

Shafiu ka thënë: Kurani është fjala e Allahut, nuk është i krijuar dhe kush thotë se është i krijuar ai është kafir.

Imam Ahmedi u burgos dhe u torturua derisa i binte të fikët duke u munduar t’ia impononin fjalën: Thuaj Kurani është i krijuar, por ai refuzonte duke thënë: Si mund të them diçka që bie në kundërshtim me atë që ka thënë Allahu dhe i Dërguari i Tij?!

Kështu pra, Allahu e përkrahu me të (imam Ahmedin) Sunetin dhe triumfoi me të e vërteta dhe u bë e qartë rruga e saktë, pasi që desh u zhduk, ndaj u quajt me meritë të plotë si: imami i Ehlu Sunetit. Dikush nga selefët ka thënë: Allahu e përkrahu fenë me Ebu Bekrin në kohën e dezertimit dhe me Ahmed ibn Hanbelin në kohën e fitnes. Pra, sa imam i mirë është ai, Allahu e mëshiroftë siç i mëshiroi vepërmirët dhe i mëshiroftë të gjithë selefët të cilët u përpoqën dhe luftuan për

triumfin e të vërtetës, Allahu na bashkoftë me ta, na bëftë prej radhëve të tyre megjithë mangësitë që kemi.

Bidatçinjtë në këtë çështje janë të ndarë në tre grupe:

1. Disa thonë se Kurani është i krijuar, si p.sh.: mutezilitë dhe kush thotë si fjala e tyre, duke i pasuar në këtë bidat të poshtër.
2. Disa thonë: Të shqiptuarit tonë me Kuran është i krijuar. Selefët këta njerëz i konsideruan bidatçinj ashtu siç i konsideruan kafira ata që thonin se Kurani është i krijuar.
3. Disa thonë: Nuk themi: është i krijuar e as nuk është i krijuar.

Nga dijetarët më të hershëm të cilët kanë shkruar rreth kësaj çështjeje, biles ai është i pari që hartoi libër për këtë, është imam Buhariu me librin e tij: Halku e falil ibad. Pra, mësojeni këtë çështje e mos lejoni që ta keni të paqartë .

Nga argumentet e kësaj çështjeje është hadithi i Ebu Musës kur ai po falej duke lexuar Kuran dhe pranë tij kaloi Profeti salAllahu alejhi ue selem i cili më pas tha: “Këtij i është dhënë zë i bukur nga zërat e Daudit”. Ebu Musa tha: Sikur ta dija se po më dëgjonte do ta zbukuroja edhe më shumë”⁵³.

Fakti që zëri ndryshon nga njëri tek tjetri apo shkrimi që ndryshon nga një njëri tek tjetri, na përforcon bindjen e mëparshme që zëri me të cilin lexohet Kurani është i krijuar, kurse vetë Kurani nuk është i krijuar.

⁵³ Transmeton Buhariu në Librin e Vlerave të Kuranit, kapitulli: Zbukurimi i zërit në leximin e Kuranit dhe Muslimi nr 793.

Imam Ahmedi ia refuzoi Husejn Kerabisit fjalën e tij që thoshte: Të shqiptuarit me Kuran është i krijuar dhe ky refuzim ishte për faktin e vetëm se kjo fjalë e thënë në këtë mënyrë linte të nënkuptoheshin të dyja mendimet. Nëse nuk do të refuzohej kjo fjalë, atëherë do e përdornin bidatçinjtë si hile dhe mashtrim, ndaj imam Ahmedi u tregua i rreptë dhe ua ndaloi të shprehurit me këtë fjalë.

Ne tani që po e përmendim këtë shprehje: Të shqiptuarit tim me Kuran është i krijuar, po e themi për shkak të mësimit sepse nuk lejohet të thuhet diçka e tillë dhe kush bën diçka të tillë është bidatçi që e ka detyrë të pendohet tek Allahu.

Autori tha: *Dhe besimi në të shikuarit e Allahut Ditën e Gjykimit siç është transmetuar nga Profeti salAllahu alejhi ue selem në hadithe të sakta.*

Shpjeguesi thotë: Nga argumentet të cilat vërtetojnë të shikuarit e Allahut në Ahiret, është fjala e Tij: “Për ata të cilët punojnë vepra të mira u takon më e mira e edhe më tepër”(Junus 26) dhe siç është komentuar në hadithin e Suhejbit: “e edhe më tepër” është për qëllim shikimi i besimtarëve Zotin e tyre ditën e Gjykimit ⁵⁴.

Argument tjetër është fjala e të Lartësuarit: “Atë ditë do ketë fytyra të hijeshuara që shkëlqejnë dhe që Zotin e tyre e

⁵⁴ Shejhu ka për qëllim hadithin ku thuhet: “Kur të hyjnë banorët e xhenetit në xhenet Allahu u thotë: A dëshironi t’u shtoj diçka më shumë? Thanë: A nuk na i ke ndriçuar dhe hijeshuar fytyrat tona? A nuk na ke futur në xhenet dhe shpëtuar nga zjarri? Tha: Atëherë e zbulon perden dhe aty e kuptojnë se nuk u është dhënë gjë më e dashur për ta sesa shikimi i Zotit të tyre” pastaj lexoi këtë ajet.....) Transmeton Muslimi nr 181.

shikojnë”(Kijameh 22-23) dhe fjala e Profetit në hadithin e saktë: “Ju do e shihni Zotin tuaj ditën e Gjykimit ashtu siç e shihni hënën e plotë duke mos u shtyrë për ta parë atë”⁵⁵.

Ka edhe hadithe të tjera në këtë çështje të cilat mund të arrijnë gradën e muteuatirit kuptimor⁵⁶, të cilat pohojnë shikimin e besimtarëve Zotin e tyre Ditën e Gjykimit, ashtu siç shohin hënën kur është e plotë në mot të kthjellët pa re apo siç shohin diellin në një ditë të kthjellët pa re.

Ky është përngjasim i shikimit me shikimin dhe jo përngjasim i atij që shihet me atë tjetrin që shihet, sepse dielli e hëna janë krijesa të Allahut dhe ky përngjasim i shikimit u bë thjesht për ta kuptuar dhe theksuar si koncept. Ashtu siç shikimi i hënës dhe i diellit pa re është jopërfshirës, po kështu shikimi i Allahut në Ahiret është shikim pa përfshirje të tërësisë së Tij.

Autori tha: *Dhe se Profeti salAllahu alejhi ue selem e ka parë Zotin e tij, sepse është transmetuar nga Profeti salAllahu alejhi ue selem hadithi i saktë nga Katadeh nga Ikrimeh nga Ibn Abasi, po ashtu nga Hakem ibn Ebani nga Ikrimeh nga Ibn Abasi dhe nga Ali ibn Zejd ibn Xhed`ani nga Jusuf ibn Mehrani nga Ibn Abasi. Këto hadithe për ne janë ashtu siç kuptohen në pamje të jashtme, siç ka ardhur nga Profeti salAllahu alejhi ue selem, ndaj të folurit rreth saj(me ploemikë) është bidat, besojmë në to siç janë transmetuar dhe nuk polemizojmë rreth saj me askënd.*

Shpjeguesi thotë: Në lidhje me shikimin e Zotit nga Profeti në dunja ka hadithe të ndryshme, p.sh: transmeton Mesruku

⁵⁵ Transmeton Buhariu nr 554 dhe Muslimi nr 633.

⁵⁶ Sh.P: Muteuatir kuptimor konsiderohet ai hadith domethënia e të cilit përcillet në hadithe të shumta, pavarësisht dallimeve që mund të kenë në tekstet e tyre.

duke thënë: Po qëndroja mbështetur në shtëpinë e Aishes kur ajo tha: O Ebu Aisheh, janë tre gjëra që sikur vetëm njëren prej tyre ta thotë dikush ka bërë shpifje të madhe ndaj Allahut. Thashë: Cilat janë ato? Tha: Kush pretendon se Muhamedi e ka parë Zotin e tij ka bërë shpifje të madhe ndaj Allahut. Tha: Pasiqë isha i mbështetur u ula dhe thashë: Oj nëna e besimtarëve prit pak e mos u ngut me mua, a nuk ka thënë Allahu: “Dhe vërtetë ai (Muhamedi) e pa atë (Xhibrilin) në horizontin e qartë lindor”(Tekuir 23), dhe: “Dhe vërtetë ai (Muhamedi) e pa atë edhe një herë tjetër”(Nexhm 13).

Tha: Unë jam e para e këtij umeti e cila e kam pyetur për këtë Profetin salAllahu alejhi ue selem dhe më ka thënë: “Ai është Xhibrili, të cilin nuk e kam parë në pamjen e tij reale siç është krijuar veçse në këto dy raste, e pushë duke zbritur nga qielli në tokë dhe me madhësinë e tij kishte pushtuar hapësirën mes qiellit dhe tokës. Tha (Aisheja): A nuk e ke dëgjuar se si Allahu thotë: “Shikimet (e njerëzve) nuk mund ta përfshijnë Atë kurse Ai i përfshin shikimet e tyre Ai është i Buti, i Njohuri hollësisht me punët e robërve” dhe a nuk e ke dëgjuar se Allahu thotë: “Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe përveçse nëpërmjet frymëzimit ose pas perdes ose të dërgojë të dërguar që të shpallë me lejen dhe vullnetin e Tij çfarë Ai do. Vërtetë Ai është më i Larti më i Urti”(Shura 51).

Tha (Aisheja): Dhe kush pretendon se Profeti salAllahu alejhi ue selem ka fshehur diçka nga Libri i Allahut ka bërë shpifje të madhe ndaj Allahut sepse Allahu thotë: “O ti i Dërguar komunikojë atë që të është shpallur ty nga Zoti yt, e nëse nuk

e bën, nuk e ke komunikuar shpalljen (dërgesën) e Tij”(Enam 67).

Tha (Aisheja): Dhe kush pretendon se është në gjendje të lajmërojë se ç`do të ndodhë në të ardhmen, veçse ka bërë shpifje të madhe ndaj Allahut sepse Allahu i Lartësuar thotë: “Thuaj: Askush në qiej dhe në tokë nuk e di të fshehtën veç Allahut dhe as nuk e dinë se kur ringjallen”(Neml 65)⁵⁷.

Po ashtu në hadithin e Ebu Dherrit i cili e pyeti Profetin salAllahu alejhi ue selem : A e pe Zotin tënd? Tha: “Kishte dritë, si ta shihja!!” në një transmetim tjetër thuhet: “shihja vetëm dritë”, në një transmetim tjetër: “Pashë dritë”⁵⁸. Në këto dy hadithe ka argument për ata që zgjodhën mendimin se Profeti salAllahu alejhi ue selem nuk e ka parë Zotin e tij natën e Israsë.

Kurse përsa i përket asaj që transmetoi Tirmidhiu nga Muxhahidi nga Shabiu i cili tha: U takua Ibn Abasi me Ka`bin në Arafat dhe e pyeti për diçka, pastaj bëri tekbir saqë oshëtinë malet. Ibn Abasi tha : Ne jemi benu Hashim. Tha Kabi: Allahu e ka ndarë të shikuarit dhe fjalën e Tij mes Muhamedit dhe Musait, i foli Musait dy herë dhe ia mundësoi Muhamedit ta shihte dy herë....”⁵⁹. Kjo është thënie e Ibn Abasit dhe transmetohet në një transmetim të kësaj fjale se Profeti salAllahu alejhi ue selem e ka parë me zemrën e tij.

Shejkhul islam Ibn Tejmijeh në Fetauat e tij thotë: Sa i përket shikimit, është vërtetuar nga Ibn Abasi se ka thënë: Profeti

⁵⁷ Transmeton Buhariu nr 4855 dhe Muslimi nr 177.

⁵⁸ Transmeton Muslimi nr 178.

⁵⁹ Transmeton Tirmidhiu nr 3279, Ibn Huzejme nr 287, Albani tha: Zinxhiri i tij është i dobët.

salAllahu alejhi ue selem e ka parë Zotin e tij me zemrën e tij dy herë⁶⁰, ndërsa Aisheja e ka mohuar që Profeti salAllahu alejhi ue selem ta ketë parë Allahun.

Disa dijetarë kanë përrputhur mes dy mendimeve duke thënë: Aisheja mohoi shikimin me sy kurse Ibn Abasi pohoi shikimin me zemër, pra nuk ka kundërthënie. Shprehjet e Ibn Abasit herë janë të përgjithshme, e herë të kufizuara në shikimin me zemër, duke thënë: E pa Muhamedi Zotin e tij, Muhamedi e ka parë, pra nuk ka shprehje të qartë që thotë ta ketë parë me sy.

Po ashtu imam Ahmedit herë shprehet në mënyrë të përgjithshme, herë thotë e pa me zemrën e tij dhe askush nuk e ka dëgjuar imam Ahmedin që të thotë: E ka parë me sytë e tij, por disa nga shoqëruesit e tij kanë dëgjuar nga ai fjalë të përgjithshme dhe kanë kuptuar se ndoshta ai kishte për qëllim shikimin me sy, ashtu siç disa kuptuan shikimin me sy nga fjala e përgjithshme e Ibn Abasit.

Nuk ekziston asnjëlloj fakti në argumente që të aprovojë shikimin e Profetit salAllahu alejhi ue selem me sy, bile as nuk është vërtetuar nga ndonjë prej sahabëve diçka e tillë. Argumentet e sakta nga Kurani dhe Suneti tregojnë të kundërtën e saj, siç transmetohet në Sahihul Muslim nga Ebu Dherri i cili tha: E pyeta Rasulullahin salAllahu alejhi ue selem: A e ke parë Zotin tënd? Tha: “Kishte dritë, si ta shihja?!”.(mbaroi thënia e Ibn Tejmijes ⁶¹)

Thashë: Kuptimi i fjalës: “Si ta shihja” është shprehje e cila tregon se drita ishte pengesë e këtij shikimi. Për këtë shkak

⁶⁰ Transmeton Muslimi nr 285.

⁶¹ Marrë nga Mexhmual Fetaua 6/509

dijetarët kanë kundërshtim në lidhje me shikimin e Profetit salAllahu alejhi ue selem Allahun natën e Israsë.

Autori tha: *Besimi në peshoren që do të jetë në Ditën e Gjykimit, siç ka ardhur në hadithin e saktë: “Do peshohet robi Ditën e Gjykimit dhe nuk rëndon as sa një krah mushkonje”, po ashtu do peshohen veprat e robërve siç ka ardhur në ether (gjurmë, transmetim). Të besuarit në këtë gjë, vërtetimin e saj dhe largimi nga ata të cilët e refuzuan dhe mos polemizimi me ta.*

Shpjeguesi thotë: Dijetarët kanë rënë në kundërshtim për peshimin e trupave të njerëzve, megjithëse ata janë dakort për peshimin e veprave. Unë them: E sakta është se trupat e njerëzve do peshohen ashtu si dhe veprat. Ndër argumentet e kësaj është fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem : “Do sillet Ditën e Gjykimit një person trupmadh, i shëndoshë por që nuk peshon tek Allahu as sa një krah mushkonje” dhe tha: Lexoni ajetin: “Nuk u japim kurrfarë vlere (peshe) Ditën e Gjykimit”(Kehf 105)⁶².

Si dhe fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem për Abdullah Ibn Mesudin i cili u ngjit në pemë për të këputur misvak dhe sahabët u çuditën nga kërcinjtë e tij të hollë: “A po çuditeni me kërcinjtë e tij të hollë?! Pasha Allahun ato janë më të rënda në peshojë sesa mali i Uhudit”⁶³.

Për peshimin e veprave ka argumente të shumta si p.sh: hadithi i kartës⁶⁴, etj.

⁶² Transmeton Buhariu nr 4729 dhe Muslimi 2785.

⁶³ Transmeton Ahmedî nr 3991, Hejthemiu 9/289 i cili tha: E transmetoi Taberaniu nr 8452 dhe Bezari me transmetues të saktë.

⁶⁴ Transmeton Ahmedî 2/668, Tirmidhiu nr 2639, e saktësoi Albani në Sahih Ibn Maxheh nr 3469

Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe Ne do të vëmë peshojat e drejtësisë Ditën e Gjykimit kështuqë askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi në asgjë edhe sikur të jetë vepra që peshon sa kokra e melit Ne do ta sjellim atë (do e vëmë në peshojë). Mjafton që Ne jemi llogaritës” (Enbija 47) dhe hadithi në të cili Profeti salallahu alejhi ue selem thotë: “Nuk ka gjë më të rëndë në peshojë se sa morali i mirë”⁶⁵ dhe hadithi: “Janë dy fjalë të dashura për Rrahmanin, të lehta në gjuhë (për tu shqiptuar), të rënda në peshojë: Subhanallahi ue bihamdihi, Subhanallahil adhim”⁶⁶.

Këto janë hadithe të sakta.

Mutezilitë e përgënjeshtroan peshojën dhe dënimin e varrit ndërsa ehlu suneti i besojnë këto gjëra.

Autori tha: 1) *Dhe se Allahu do u flasë robërve Ditën e Gjykimit pa pasur mes Tij e tyre përkthyes, të besuarit në këtë dhe vërtetimi i tij.*

2) *Dhe besimi në Haudin (rezervuarin) e Profetit salAllahu alejhi ue selem , pra ai do të ketë në ditën e Gjykimit një rezervuar tek i cili do vijë për të pirë ujë umeti i tij, gjerësia e tij është sa gjatësia e tij: ecje një muaj, enët e tij janë sa yjet e qiellit, të gjitha këto janë saktësuar në transmetime në më shumë se një rrugë transmetimi.*

Shpjeguesi thotë: 1) Ndër argumentet e kësaj çështjeje është hadithi i saktë: “Nuk ka njeri nga ju veçse Allahu do i flasë atij Ditën e Gjykimit pa pasur mes tyre përkthyes”⁶⁷.

⁶⁵ Transmeton Tirmidhiu nr 2003, saktësoi Albani në Sahihul Xhamiu es-Sagir nr 5726.

⁶⁶ Transmeton Buhariu nr 6406 dhe Muslimi nr 2694.

⁶⁷ Transmeton Buhariu nr 6539 dhe Muslimi nr 1016.

2) Ndër hadithet të cilat flasin për rezervuarin e Profetit salAllahu alejhi ue selem është ajo çfarë ka transmetuar Buhariu nga një grup sahabësh, prej tyre Ebu Hurejra, Esma bint Ebi Bekri, etj, hadithe të cilat që të gjitha vërtetojnë se Profeti salAllahu alejhi ue selem do ketë rezervuar tek i cili do vijnë besimtarët dhe nga ku do të dëbohen tejkaluesit në gjynahe dhe vepruesit e bidateve nga umeti i tij.

Nga këto hadithe është fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem : “Do vijnë tek unë për të pirë nga rezervuari disa njerëz dhe sapo bëhem gati që t`u jap ujë, del një burrë mes meje dhe tyre dhe u thotë atyre: Ecni. Unë i them: Për ku? Thotë: Për në zjarr vallahi. Unë i them: Ata janë shokët e mi. Thotë: Ti nuk e di se çfarë kanë shpikur pas teje”⁶⁸. Hadithet në këtë temë janë të shumta.

Autori tha: *(1) Dhe besimi në dënimin e varrit dhe se ky umet do sprovohet në varr dhe do pyetet për:*

1) Imanin dhe Islamin, do pyetet: 2) Kush është Zoti yt? 3) Kush është Profeti yt?

(2) Do i vijë Munkeri dhe Nekiri (dy engjëjt që e marrin në pyetje) ashtu siç dëshiron Allahu, ndaj të besosh në këtë dhe ta vërtetosh (aprovosh) atë.

Shpjeguesi thotë: **1)** Dënimi i varrit është diçka, formën e së cilës nuk e di askush përveç Allahut. I vdekuri gjatë qëndrimit të tij në varr mund të vuajë ose të përjetojë kënaqësi. Dënimi i varrit dhe kënaqësia në të janë vërtetuar në tekste të shumta

⁶⁸ Transmeton Buhariu nr 6576 dhe Muslimi nr 2304.

të cilat arrijnë gradën e muteuatirit⁶⁹ por edhe nëse nuk kanë arritur muteuatirin më së paku janë të shumta të mirënjohura. Ka ardhur në hadith se Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Sikur të mos ishte që njerëzit duhet ta varrosin njëri-tjetrin do ta lusja Allahun që tua bëjë të mundur të dëgjoni nga dënimi i varrit atë që unë dëgjoj”⁷⁰.

Në dy Sahihet transmetohet se Profeti salAllahu alejhi ue selem kaloi pranë dy varreve dhe tha: “Këta të dy po dënohen dhe nuk po dënohen për diçka të madhe (sipas tyre), njëri prej tyre merrej me thashetheme kurse tjetri nuk ruhej nga urina” pastaj kërkoi t’i sillnin një degë peme të njomë dhe vendosi në secilin varr nga një gjysëm (dege) pastaj tha: Shpresoj që t’u lehtësohet dënimi derisa të thahen këto degë”⁷¹.

Hadithi i Berra bin Azibit⁷² është gjithashtu argument për këtë. Po ashtu janë transmetuar argumente për përjetimin e kënaqësive në varr, si ajo që transmetohet se shpirtrat e dëshmorëve janë në formë të disa zogjve të gjelbërt, shëtisin nëpër xhenet dhe kthehen tek disa kandila të varura në Arsh”⁷³.

⁶⁹ Sh.P: Muteuatir konsiderohet ai hadith i besueshëm i cili ka një numër të shumtë të rrugëve të transmetimit, deri në atë pikë saqë bëhet e pamundur logjikisht të pranohet që të gjithë ata transmetues të kenë rënë dakort mes tyre për ta shpikur atë transmetim.

⁷⁰ Transmeton Muslimi nr 2867.

⁷¹ Transmeton Buhariu nr 216 dhe Muslimi nr 111.

⁷² Transmeton Ahmedi nr 18559, Ebu Daudi nr 4753, e ka saktësuar Albani Sahihi suneni Ebi Daud nr 3977

⁷³ Transmeton Muslimi nr 1887.

Pretenduan disa se dënimi i varrit nuk mund të paramendohet të ekzistojë sepse mendjet e tyre nuk janë në gjendje ta përfytyrojnë diçka të tillë. Ata thonë: Nëse do e hapim varrin e ndonjë të vdekuri do shohim eshtrat e tij të kalbura dhe nuk do gjejmë asnjë shenjë dënimi apo përjetimi kënaqësie. Ky është mendimi i mutezilive dhe i atyre që flasin duke iu mbështetur logjikës në kohën tonë si p.sh.: Hizbu Tahrir (Partia e çlirimit).

Dijetarët kanë rënë në kundërshtim se a do të jetë dënimi i varrit vetëm për shpirtin apo vetëm për trupin apo ndaj të dyjave së bashku? Mendimi më afër të vërtetës është se dënimi dhe kënaqësia janë për shpirtin dhe se trupi përjeton një pjesë të asaj që përjeton shpirti⁷⁴.

2) Pyetja që do zhvillohet nga Munkeri dhe Nekiri është vërtetuar në hadithin e Berra bin Azibit e të tjerë: “Robi kur vdes dhe varroset i vijnë dy engjëj, njëri quhet Munker dhe tjetri Nekir, që të dy e pyesin dhe i thonë atij: Kush është Zoti yt? Kush është feja jote? Kush është ai burrë i cili u dërgua nga mesi juaj? Besimtari përgjigjet duke thënë: Allahu është Zoti im, feja ime është islami dhe Muhamedi është Profeti im. I thonë atij: Fli, ne e kemi ditur se ti ke qenë besimtar, atëherë i hapet një derë nga ku shihet zjarri dhe i thuhet: Ky do të ishte vendi yt nëse do mohoje, pastaj i hapet një derë nga ku shihet xheneti dhe i thuhet: Ky do të jetë vendi yt nesër inshallah. Personi thotë: O Zot bëje sa më shpejt Kijametin, o

⁷⁴ Sh.p: Pra shpirti në këtë rast është primar kurse trupi sekondar, është pasues i shpirtit në përjetim.

Zot bëje sa më shpejt Kijametin! Ndërsa kafiri apo munafiku përgjigjet duke thënë: Ah, ah, nuk e di, i dëgjoja njerëzit që thoshin diçka dhe e thoja me ta. Aty goditet me një çekiç që sikur të goditej me të një mal do e bëntë dhe, bërtet me një britmë që e dëgjon çdo krijesë e Allahut përveç xhinëve dhe njerëzve sepse nëse do ta dëgjonte xhini apo njeriu do të vdiste”. Kjo është vetëm një pjesë e dënimit të varrit.

Autori tha: *Dhe të besuarit në ndërmjetësimin e Profetit salAllahu alejhi ue selem .*

Shpjeguesi thotë: Hadithet që flasin për shefatin (ndërmjetësimin) në Ahiret janë muteuatir. Shefati i Profetit salAllahu alejhi ue selem është shtatë llojesh, tre i përkasin në mënyrë të veçantë Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe katër janë të përgjithshëm për të dhe për të tjerët. Llojet të cilat i përkasin Profetit salAllahu alejhi ue selem janë:

1. Shefati për fillimin e gjyqimit dhe ky është Mekamul Mahmud (pozita e lavdërueshme) të cilën profetët e zgjedhur e refuzojnë (sepse nuk u përket atyre) derisa vjen radha tek Profeti ynë i cili thotë: Unë jam për të, unë jam për të.
2. Shefati për hapjen e derës së xhenetit gjë e cila është e veçantë për Profetin salAllahu alejhi ue selem .
3. Shefati për lehtësimin e dënimit të Ebu Talibit.

Ndërsa shefatet e tjera janë të përbashkëta mes Profetit dhe profetëve të tjerë dhe të sinqertëve dhe dëshmorëve dhe besimtarëve, të cilat janë:

1. Shefati për njerëz të cilët e kanë merituar dënimin për shkak të gjynaheve që kanë bërë, bëhet shefat për ta

që të mos dënohen dhe të hyjnë në xhenet pa u dënuar më parë.

2. Shefati për njerëz që kanë hyrë në zjarr për shkak të gjynaheve të tyre, bëhet shefat për ta nga ndërmjetësuesit për t'i nxjerrë nga zjarri dhe për t'i futur në xhenet.
3. Shefati për njerëz që kanë merituar grada të ulëta në xhenet, bëhet shefat për ta që tu rriten gradat më shumë se sa e kanë merituar, mirësi nga Allahu.
4. Shefati për ata që qëndrojnë në vendin e quajtur Araf ndërmjet xhenetit dhe xhehenemit të cilët janë ata që i kanë të mirat dhe të këqijat të barabarta, të mirat i kanë shpëtuar ata nga hyrja në zjarr ndërsa të këqijat e tyre i kanë penguar nga hyrja në xhenet, bëhet shefat për ta që Allahu t'i falë dhe për të hyrë në xhenet.

Të gjitha këto janë vërtetuar në hadithe që arrijnë gradën e muteuatirit.

Autori tha: *Dhe besimi se disa njerëz do dalin nga zjarri pasi janë djegur dhe shndërruar në thëngjill. Nxirren dhe hidhen në lumë tek dera e xhenetit, si të dojë Allahu, siç ka ardhur në transmetim. Të besuarit në të dhe vërtetimi i tij.*

Shpjeguesi thotë: Kjo tregon se muslimanët që do dënohen në zjarr do vdesin në të. Ndërsa të tjerët veç tyre as nuk vdesin e as nuk rrojnë. Lumi i jetës ndodhet brenda derës së xhenetit, aty hidhen dhe mbijnë trupat e tyre ashtu siç mbin fara anës përroit.

Hauarixhët dhe mutezilitë e mohuan shefatin duke thënë se kush bën gjynah të madh prej muslimanëve do jetë përgjithmonë në zjarr.

Autori tha: *Dhe besimi në daljen e mesihut Dexhal i cili ka të shkruar mes dy syve të tij Kafir dhe besimi në hadithet që janë transmetuar rreth tij dhe se kjo do ndodhë.*

Shpjeguesi thotë: Mesihu Dexhal ka një të përbashkët me Isain birin e Merjemes: ajo është se të dy quhen mesih dhe dallimi mes tyre bëhet me pjesën e dytë të emrit duke thënë për Dexhalin: mesihu Dexhal kurse për Isain: Mesihu Isai biri i Merjemes.

U quajt Dexhali me emrin mesih siç thonë dijetarët nga fakti se do kalojë nëpër të gjithë tokën në ditët e caktuara për të ose nga fakti që syrin e djathtë e ka të fshirë, të zhdukur. Kanë ardhur hadithe rreth përshkrimin të tij, daljes së tij, fitnes që bart me vete, do ketë me vete zjarr, do urdhërojë qiellin të lëshojë shi, do urdhërojë tokën të mbijë, u bën fitne njerëzve duke i thërritur që t'i besojnë atij duke u thënë se është Zoti i tyre.

Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Cdo profet para meje ia ka tërhequr vërejtjen popullit të tij nga Dexhali por unë do u them juve diçka që asnjë profet para meje nuk e ka thënë: Me të vërtetë Dexhali është i verbër në syrin e tij të djathtë dhe e ka si kokërr rrushi të thatë, me të vërtetë Zoti juaj nuk është i verbër”⁷⁵.

Autori tha: *Dhe se Isai i biri i Merjemes do zbresë në atë kohë dhe do e vrasë Dexhalin tek porta e Ludit.*

Shpjeguesi thotë: Është përshkruar zbritja e Isait kështu: Ndërkohë që muslimanët po presin për të falur namazin e

⁷⁵ Transmeton Muslimi nr 2936.

sabahut, Isai ibn Merjem zbret i veshur me petk dhe mantel dhe me duart e vendosura në krahët e dy engjëjve, vjen në momentin kur bëhet ikameti për namaz dhe Mehdiu i thotë atij: Dil dhe falu, ai thotë: Prijësit tuaj duhet të jenë nga mesi juaj. Pastaj del duke ndjekur Dexhalin duke mbajtur në dorë një heshtë, e arrin tek porta e Ludit⁷⁶dhe e shpon me heshtë, pastaj vjen tek besimtarët duke i përgëzuar dhe lajmëruar për vendet e tyre në xhenet⁷⁷.është transmetuar se Isai salAllahu alejhi ue selem martohet me vajzën e Mehdiut.

Autori tha: *Dhe se besimi (imani) është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet, siç ka ardhur në hadith: “Besimtari me imanin më të plotë është ai që ka moralin më të mirë”.*

Shpjeguesi thotë: Imani është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet ndryshe nga ç’thonë murxhitë⁷⁸ të cilët thonë se imani as nuk shtohet e as nuk pakësohet dhe pretendojnë se besimi i muslimanëve gjynahqarë është i njëjtë me imanin e Xhibrilit, pretendim i cili është i kotë.

Për shtimin e imanit argumetojnë ajete të shumta nga Kurani, Allahu i Lartësuar thotë në suren Mudethir: “E atyre që besuan u shtohet dhe më shumë besimi dhe të mos lihet asnjë dyshim për ata që u janë dhënë librat më parë”(Mudethir 31) dhe thotë: “ Allahu ua shton udhëzimin (besimin) atyre të cilët janë të udhëzuar”(Merjem 76), etj.

⁷⁶ Ludi është një fshat pranë Bejtul Makdisit.Marrë nga shpjegimi i Neueuiut ndaj Sahihu Muslimit 17/271

⁷⁷ Deri këtu është marrë nga hadithi që transmeton Muslimi me nr. 2137

⁷⁸ Sh.P: Një sekt i devijuar,që pretendojnë se besimi as nuk shtohet as nuk pakësohet, veprat nuk ndikojnë tek besimi, e disa idera të tjera që në fakt nxisin shthurjen dhe mungesën e besimit.Boshti i pretendimit të tyre është: Besimi është fjalë goje, që s`ka nevojë për vepra!

Selefët kanë bërë të qartë se ajo gjë e cila shtohet mund edhe të pakësohet. Nga argumentet që tregojnë për uljen dhe ngritjen e besimit është fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem : “Banorët e Xhenetit i shohin nga poshtë banorët e dhomave ashtu siç ju e shihni yllin ndriçues në horizontin lindor, kjo për shkak të diferencës që ka mes tyre”. Thanë: O i Dërguari i Allahut ata janë në gradat e profetëve të cilat nuk mund t’i arrijë askush!! Profeti salAllahu alejhi ue selem tha: “Përkundrazi, pasha Atë i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit, mund të arrijnë në ato grada, njerëz të cilët i kanë besuar Allahut dhe i kanë vërtetuar bindshëm profetët”⁷⁹. Gjithashtu argumentojnë për këtë hadithet e shefatit, Allahu i Lartësuar do u thotë engjëjve: “Nxirrni nga zjarri çdokënd i cili ka në zemrën e tij hajr (mirësi) sa pesha e një dinari, pastaj nxirrni çdokënd i cili ka në zemrën e tij hajr (mirësi) sa pesha e një gjysëm dinari” në një transmetim tjetër në vend të fjalës hajr thuhet “besim”, “Pastaj nxirrni çdokënd i cili ka në zemrën e tij sa pesha e një bërthame hurme(arabe).....pastaj sa një grimcë.....pastaj sa grimca më e vogël e besimit që ekziston”⁸⁰.Kjo pra vërteton diferencat në besim mes njerëzve dhe gradat e ndryshme të tyre në xhenet.

Autori tha: *Dhe se: “Kush e lë namazin ka bërë kufr” dhe se: Lënia e çdo lloj vepre tjetër nuk është kufr përveç namazit, kush e lë atë është kafir dhe Allahu e ka bërë të lejuar vrasjen e tij.*

Shpjeguesi thotë: Kjo është një pjesë nga teksti i hadithit që transmetohet nga Profeti salAllahu alejhi ue selem nëpërmjet Burejde bin Husejbit radijAllahu anhu tek librat e Suneneve me zinxhir të saktë, po ashtu nëpërmjet Enesit radijAllahu

⁷⁹ Transmeton Buhariu nr 3256 dhe Muslimi nr 2831.

⁸⁰ Transmeton Buhariu nr 7510 dhe Muslimi nr 326.

anhu tek Muslimi. Teksti i plotë i hadithit të Burejdes është: “Marrëveshja mes nesh e tyre është namazi, kush e lë atë ka bërë kufr”⁸¹, teksti i hadithit të Enesit është : “Ndërmjet njeriut dhe kufrit është lënia e namazit”⁸².

Ebu Uail Shekik ibn Selemeh ka thënë: “Sahabët nuk e shihnin lënien e asnjë vepre si kufr përveç lënies së namazit⁸³. Ndërsa imam Ahmedi e transmetoi këtë fjalë duke thënë: Lënia e çdo lloj vepre tjetër nuk konsiderohet kufr përveç lënies së namazit, kush e lë atë është kafir dhe Allahu e ka bërë të lejuar vrasjen e tij.

Autori tha: *Dhe besimi se njeriu më i mirë i këtij umeti pas Profetit salAllahu alejhi ue selem është Ebu Bekri pastaj Umer ibn Hatabi pastaj Uthman bin Afani, u japim përparësi këtyre treve ashtu siç u dhanë atyre përparësi sahabët, pa pasur kundërshtim mes tyre për këtë gjë. Pas këtyre të treve vijnë anëtarët e shuras (konsultimit): Aliu, Talha, Zubejri, AbduRrahman bin Aufi, Sa`di, të gjithë këta ishin të përshtatshëm për të qenë halife dhe të gjithë ishin prijës. Për çfarë thamë kemi si argument hadithin e Ibn Umerit ku thuhet : Kur Profeti ishte gjallë dhe shokët e tij ishin të shumtë, ne i renditnim njerëzit duke thënë: Ebu Bekri është i pari (më i miri) pastaj Umeri pastaj Uthmani pastaj heshtnim”.⁸⁴*

Pas anëtarëve të konsultimit vijnë ata muhaxhirë që morën pjesë në luftën e Bedrit pastaj ensarët që morën pjesë në Bedr, secili duke u vlerësuar në pozitë sipas kohës së emigrimit dhe përparësisë në fe (kush hyri më herët në fe).

⁸¹ Transmeton Ahmedi nr 22998, Tirmidhiu nr 2621, Hakimi nr 11, saktësoi Albani në Mishkatul mesabih nr 574.

⁸² Transmeton Muslimi nr 134

⁸³ Transmeton Tirmidhiu nr 2622 , Hakimi nr 12.

⁸⁴Transmeton Buhariu .

Shpjeguesi thotë: Muslimanët e kanë detyrë që t'i pasojnë sahabët në këtë çështje.

Ajo që dihet është se anëtarët e konsultimit kanë qenë gjashtë, përveç atyre të pestëve që u përmendën është dhe Seid Ibn Zejdi i cili ka qenë anëtar i konsultimit por që autori nuk e përmendi, nuk e di a është teksti original kështu apo mund ta kenë harruar shtypësit e librit që ta shkruajnë.

Pas anëtarëve të konsultimit renditen ata që morën pjesë në besëlidhjen e Akabesë, pastaj ata që luftuan në Bedr nga muhaxhirët dhe ensarët, pastaj ata që morën pjesë në besëlidhjen Riduan, pastaj ata që pranuan islamin para çlirimit të Mekes dhe që emigruan dhe luftuan, pastaj ata që pranuan islamin pas çlirimit të Mekes, pastaj sahabët e vegjël. Kështu është renditja e sahabëve sipas pozitës dhe vlerës që kanë.

Autori tha: *Njerëzit më të mirë pas sahabëve që përmendëm janë brezi në të cilin jetoi Profeti salAllahu alejhi ue selem , çdokush i cili e shoqëroi Profetin salAllahu alejhi ue selem një vit apo një muaj apo një ditë apo një orë apo vetëm e ka parë një here, konsiderohet sahabij.*

Shoqërimi është në varësi të qëndrimit me të dhe kohës së hyrjes në islam dhe dëgjimit prej tij dhe shikimit të tij. Sahabiu me shoqërimin më të pakët është më i mirë se brezi të cilët nuk e kanë parë Profetin salAllahu alejhi ue selem edhe sikur ata (tabiinët) ta takojnë Allahun me të gjitha llojet e veprave të mira. Ata të cilët e shoqëruan Profetin salAllahu alejhi ue selem , e panë atë, e dëgjuan fjalën e tij, pra çdokush që e pa atë qoftë dhe për një kohë të shkurtër duke i besuar atij (si Profet) është më i mirë se tabiinët për shkak të këtij shoqërimi edhe sikur tabiinët të bëjnë të gjitha veprat e mira.

Shpjeguesi thotë: Argumenti i dallimit të sahabëve ndaj çdokujt tjetër pas tyre është fjala e Profetit salAllahu alejhi ue sem : “Mos i shani shokët e mi sepse pasha Atë i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit sikur ndonjëri prej jush të shpenzojë (sadaka) flori sa mali i Uhudit, nuk e arrin vlerën e shpenzimit të sasisë sa një grusht nga ana e tyre, biles as gjysmën e grushtit”⁸⁵.

Pra, kjo tregon për pozitën e madhe të tyre tek Allahu.

Të nxira dhe të poshtëruara janë fytyrat e atyre të cilët flasin keq për sahabët apo i konsiderojnë kafira ata apo ua ulin vlerën atyre. Ne besojmë se kush bën diçka të tillë është bidatçi i humbur, humbës i të tjerëve, që do e gjejnë atë që meritojnë para Zotit të tyre.

Ata që flasin keq për sahabët janë dy grupe (sekte):

1. Hauarixhët, të cilët përveç Ebu Bekrit dhe Umerit të tjerë i konsiderojnë kafira duke përfshirë dhe Aliun e të tjerë, të cilët (Aliu dhe këta të tjerët) nderohen nga rafidat.
2. Rafidat të cilët bëjnë përjashtim nga ky ofendim vetëm për Aliun e një numër të vogël me të si p.sh.: Selman Farisiun, Amar bin Jasirin, Ebu Dherrin, një numër që nuk i kalon dhjetë veta, të tjerët veç këtyre i konsiderojnë kafira duke filluar me Ebu Bekrin dhe Umerin e duke mbaruar me sahabiun më të vogël duke përfshirë dhe dy gratë e Profetit salAllahu alejhi ue sem, Aishen vajzën e Ebu Bekrit dhe Hafsën, vajzën e Umerit (Zoti qoftë i kënaqur me to dhe me prindërit e tyre).

⁸⁵ Transmeton Buhariu nr 3673 dhe Muslimi nr 2541.

Autori tha: *Bindja dhe dëgjueshmëria ndaj prijësave dhe udhëheqësit suprem musliman (emirul muminin) qoftë ky emir i mirë (i devotshëm) apo mëkatar, përderisa ka ardhur në pushtet (krye te halifatit) dhe njerëzit janë bashkuar rreth tij dhe janë të kënaqur me të (e kanë pranuar atë) edhe sikur të jetë ky emir që e ka marrë pushtetin me forcë (me shpatë) duke u bërë halife dhe duke u quajtur emirul muminin.*

Shpjeguesi thotë: Imam Ahmedi bëri të qartë se çdo musliman e ka detyrë që të dëgjojë dhe t'i bindet atij që Allahu i ka ngarkuar një punë nga punët e përgjithshme të muslimanëve qoftë ky përgjegjës i mirë (i devotshëm) apo i keq (gjynahqar) sepse Profeti salAllahu alejhi ue semem ka thënë: “Dëgjoni dhe binduni edhe sikur të vendoset si udhëheqës i juaji një rob etiopias i gjymtuar”⁸⁶, në një transmetim tjetër thuhet: “edhe nëse e ka kokën si kokërr rushi e thatë”⁸⁷. Hadithet në këtë temë janë të shumta dhe që duhen lexuar në librat ku gjenden ato.

Autori tha:

- 1. Xhiahadi është i vazhdueshëm deri në Ditën e Gjykimit duke marrë pjesë në beteja nën komandën e prijësave, qofshin ata të mirë apo të këqinj, nuk lihet lufta asnjëherë për këtë shkak.*
- 2. Ndarja e plaçkës së luftës është diçka e vazhdueshme dhe është e drejtë vetëm e tyre (prijësave). Nuk i lejohet askujt që t'i ofendojë ata apo të ngrejë krye ndaj tyre.*

⁸⁶ Transmeton Muslimi nr 1463.

⁸⁷ Transmeton Buhariu nr 7142.

Shpjeguesi thotë:

1. Lufta nën udhëheqjen e prijësit, falja e namazit pas tij në xhuma dhe Bajrame, këto janë detyrë për çdokënd i cili gjendet nën udhëheqjen e tij. E kanë detyrë që të luftojnë së bashku me të ndaj kafirave dhe t'i luftojnë zullumqarët (kryengritësit ndaj prijësit) siç ka urdhëruar Allahu: “Nëse njëra palë bën zullum ndaj palës tjetër (duke e sulmuar atë) atëherë luftojeni atë palë zullumqare derisa t'i kthehet të drejtës” (Huxhurat 9).

Kush e refuzon bindjen dhe ngre krye ndaj prijësit që njerëzit e pasojnë dhe që muslimanët e kanë pranuar sundimin e tij, është gabimtar gjynahqar. Përkundrazi, është detyrë bindja ndaj prijësit dhe luftimi nën flamurin e tij, qoftë ardhja e tij në pushtet me konsultim apo nëpërmjet forcës dhe imponimit, kush lë mangut në këtë gjë do jetë përgjegjës para Allahut sepse ka lënë një vaxhib.

2. Imam Ahmedi në këtë pikë qartësoi të drejtat e prijësive: ndarja e plaçkës së luftës u takon atyre, zbatimi i ligjeve dhe ekzekutimi i dënimeve u takon atyre, nuk i lejohet askujt që të marrë përsipër diçka nga këto që përmendëm sepse janë e drejtë vetëm e prijësive, po kështu dhënia e të drejtës atij që i është bërë padrejtësi apo gjykimi mes njerëzve për të shuar grindjet dhe konfliktet, e tjera si këto.

Autori tha: *Mbledhja e zekatit nga prijësit është e vlefshme dhe konsiderohet se e ka kryer dhënien e tij, pavarësisht nëse prijësi është i drejtë apo zullumqar.*

Shpjeguesi thotë: Nga të drejtat e prijësive është mbledhja e zekatit dhe si detyrë institucionale kjo është një nga të drejtat ekskluzive të sundimtarit (të pushtetit) dhe nuk lejohet që këtë detyrë ta marrë përsipër dikush tjetër në vend të sundimtarit ⁸⁸ apo personit të caktuar prej tij. Nëse dikush ia jep zekatin e tij njerëzve të paautorizuar nga sundimtari, e ka detyrë ta përsërisë dhënien e tij.

Autori tha: *Namazi i xhumasë që falet duke pasur si imam sundimtarin apo personin e autorizuar prej tij, është i vlefshëm me ato dy rekate. Konsiderohet i plotë, korrekt dhe kështu duhet të veprohet, nëse dikush e përsërit atë namaz duke e konsideruar të pavlefshëm imamllëkun e sundimtarit ky është bidatçi që ka lënë pas dore transmetimet dhe ka rënë ndesh me Sunetin. Nuk përfiton asgjë nga vlera e xhumasë nëse nuk beson se lejohet namazi pas sundimtarëve, sido që të jenë ata, të mirë apo të këqinj, sepse Suneti është që të falësh me ta xhumanë dy rekate dhe të besosh se ai namaz është i plotë, mos të ndjesh asnjë lloj sikleti në lidhje me këtë.*

Shpjeguesi thotë: Namazi me xhemat, ai i xhumasë dhe Bajrameve, është detyrë që të falen me prijësin dhe kush pretendon se namazi i xhumasë nuk është i vlefshëm pas sundimtarit që prin në namaz, duke vënë si kusht për namazin e vlefshëm që të jetë imam i pagabueshëm nga

⁸⁸ Sh.p: Përveç nëse shteti e lejon diçka të tillë për organizma apo shoqata të ndryshme jo shtetërore

pasardhësit e Profetit salAllahu alejhi ue selem , siç thonë shiat apo çdokush tjetër që ka mendimin e tyre, ky konsiderohet bidatçi i humbur.Nuk lejohet ky lloj pretendimi dhe as nuk lejohet të dyshojë në vlefshmërinë e namazit të xhumasë, ky është qëndrimi i ehlu sunetit.

Autori tha: *Kush ngre krye ndaj një prijësi nga prijësat e muslimanëve pasi që njerëzit janë bashkuar rreth atij prijësi dhe e kanë pranuar sundimin e tij, qoftë ky sundim i arritur me pëlqim apo me mbizotërim (me forcë), pra ai rebel që ngre krye ndaj këtij prijësi ka përçarë muslimanët dhe ka kundërshtuar transmetimet nga Profeti salAllahu alejhi ue selem. Nëse vdes i rebeluari në atë gjendje vdes me vdekje të injorancës (xhahilijetit).*

Shpjeguesi thotë: Nuk lejohet kryengritja dhe dalja kundër prijësit edhe sikur ai të jetë gjynahqar. Huruxhi (rebelimi, kryengritja, dalja kundër) është dy llojesh:

1. Ngritje krye me veprime dhe luftë.
2. Ngritje krye me fjalë dhe me nxitje kundra prijësit.

Ka ardhur në hadithin e Ubadete bin Samitit radijAllahu anhu se Profeti salAllahu alejhi ue selem i thërriti që t'i jepnin besën dhe ia dhanë për dëgjueshmëri dhe bindje në vështirësi dhe lehtësi, në çfarë u vjen e lehtë dhe çfarë u vjen rëndë dhe që të mos kërkojnë tua marrim pushtetin atyre që e kanë, përveç nëse shohin kufër të qartë,të kryer haptasi, për të cilin kanë argument nga Allahu”⁸⁹. Hadithet në këtë temë janë të

⁸⁹ Transmeton Buhariu nr 7056 dhe Muslimi nr 1709.

shumta e të mirënjohura si p.sh.: fjala e Profetit salAllahu alejhi ue semem : “Kush del kundra sundimitarit dhe vdes në atë gjendje ka vdekur me vdekje të injorancës”⁹⁰.

Konsiderohet nga elementët e huruxhit (rebelimit) përmendja e të metave të prijësive, ofendimi i tyre, t'i qortosh ata në mes të njerëzve, nënçmimi i tyre, sepse këto veprime sjellin si pasojë rreziqe të mëdhaja dhe dëme të pallogaritshme, sepse kjo shkakton nxitjen e kundërshtimit me veprime dhe çon deri në rebelim (aktiv) me veprime, e nëse ndodh rebelimi me veprime derdhen gjaqet, shkelen nderet, ndërpriten rrugët, frikësohen njerëzit.

U përkujtoj në emër të Allahut, ruajeni umetin e Muhamedit, o ju nxënës të dijës mos u mashtroni nga ata veprimtarë politikë, sepse shteti ynë (Saudia) është shtet islam, gjykon me sheriatin e Allahut përhap drejtësinë dhe teuhidin, e lusim Allahun tu japë sukses pushtetarëve për çdo të mirë.

Ne nuk pretendojmë pagabueshmërinë, patjetër që do të ketë gabime por korrigjimi i gabimeve duhet bërë me mënyra të cilat sjellin dobi e jo dëm, si p.sh: këshillimet në mënyrë private, etj, pa dashur të zgjerohem në këtë temë por këto ishin thjesht disa maja lapsash dhe si tërheqje e vëmendjes ndaj gabimeve të bidatçinjve duke shpresuar në Allahun që të bëjë dobi me to dhe të na ruajë nga sherri i bidateve, me të vërtetë Ai është Bujar, Fisnik.

⁹⁰ Transmeton Buhariu nr 7054 dhe Muslimi nr 1849.

Autori tha: *Nuk lejohet luftimi i sundimtarit dhe nuk i lejohet askujt rebelimi ndaj tij, kush e bën diçka të tillë është bidatçi i dalur jashë rrugës së drejtë dhe Sunetit.*

Shpjeguesi thotë: Allahu ka urdhëruar për bindje ndaj sundimtarit për sa kohë që ai është musliman dhe nuk lejohet dalja kundra tij edhe nëse ai bën padrejtësi edhe nëse të godet kurrizin e të merr pasurinë, sepse Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë në hadithin e Hudhejjes radijAllahu anhu: “Dëgjo dhe bindju prijësit edhe nëse të godet kurrizin dhe të merr pasurinë”⁹¹.

Tek ehlu suneti nuk lejohet dalja kundra tij, përveç nëse shihet kufër i qartë haptasi për të cilin të ketë argument tek Allahu⁹²

Havarixhët dhe mutezilitë e kanë lejuar rebelimin, këto dy grupacione të cilët janë bidatçinj.

Kapu pas njerëzve që janë pasues dhe largohu nga ata që janë shpikës (bidatçinj) sepse rruga e vërtetë është rruga e pasuesve të transmetimeve.

Autori tha: *Luftimi i hajdutëve dhe havarixhëve është i lejuar nëse cënojnë njerëzit fizikisht apo në pasurinë e tyre, i lejohet personit që të luftojë për të mbrojtur veten dhe pasurinë e tij, por nuk i lejohet që t'i ndjekë për t'i vrrarë apo t'i kërkojë pasiqë largohen prej tij, sepse kjo i takon vetëm prijësit dhe përgjegjësve të muslimanëve. Pra, personi ka të drejtë të vetëmbrohet dhe fillimisht ta ketë qëllim që të mos vrasë*

⁹¹ Transmeton Muslimi nr 1847.

⁹² Sh.p: Edhe në këtë rast me kusht që të ekzistojë mundësia për ta larguar atë nga pushteti pa shkaktuar dëme më të mëdha.

askënd, por nëse ndonjëri (prej havarixhëve apo hajdutëve) vdes gjatë vetëmbrojtjes së personit të sulmuar, Allahu e largoftë këtë të vrarë nga mirësitë.

Shpjeguesi thotë: Luftimi i zullumqarëve, i agresorëve, i hajdutëve apo i havarixhëve, është i lejuar nëse e cënojnë personin në veten apo pasurinë e tij, ndërsa nëse duan t'i shkelin nderin e ka detyrë t'i luftojë ata me çdo mjet që të ketë mundësi. Imam Ahmedi në këtë pikë qartësoi se nuk duhen ndjekur ata që largohen, sepse Aliu radijAllahu anhu kur i luftoi havarixhët dha urdhër që të mos ndiqeshin ata që largoheshin dhe Aliu është nga halifet e drejtë , shembullin e të cilëve duhet të ndjekim.

Autori tha: *Nëse vritet duke mbrojtur veten dhe pasurinë e tij shpresoj që të jetë shehid siç ka ardhur në hadith. Në të gjitha transmetimet ka ardhur urdhëri për luftimin e tij (agresorit) e jo për vrasjen e tij dhe as për ndjekjen e tij. Nëse është i plagosur ose i rrëzuar nuk i jepet fund (duke e vrarë), nëse e zë rob nuk i lejohet ta vrasë e as të zbatojë mbi të dënimin, por ia dorëzon çështjen atij që është përgjegjës që të gjykojë në lidhje me të.*

Shpjeguesi thotë: Kjo sepse është transmetuar në hadithin e Ebu Hurejres se ai tha: Erdhi një burrë tek Profeti salAllahu alejhi ue selem dhe tha: O Rasulullah: çfarë mendon nëse vjen dikush dhe kërkon të ma marrë pasurinë, tha: “Mos ia jep”. Tha: Po nëse më lufton? Tha: “Luftoje”. Tha: Po nëse më vret? Tha: “Ti je shehid”. Tha: Po nëse e vras? Tha: “Ai është në zjarr”⁹³, në hadithin tjetër thuhet: “Kush vritet duke mbrojtur

⁹³ Transmeton Muslimi nr 140.

pasurinë e tij është shehid, kush vritet duke mbrojtur veten e tij është shehid, kush vritet duke mbrojtur fenë e tij është shehid⁹⁴.

Nuk vritet i plagosuri i tyre, nuk ndiqet ai që ikën, nuk u merren pasuritë si plaçkë lufte, nuk u merren gratë robëresha, sepse në origjinë gjykimi për ta është që janë muslimanë.

Autori tha: *Dhe nuk dëshmojmë për askënd nga ehlul kibleh (muslimanët) se është në xhenet apo në zjarr duke u bazuar vetëm në veprat e jashtme, por shpresojmë për vepërmirin dhe kemi frikë për të (nga të fshehtat që mund të ketë), kemi frikë për gjynahqarin punëkeq dhe shpresojmë për të mëshirën e Allahut.*

Shpjeguesi thotë: Nuk lejohet të dëshmohet për askënd nga ata që i drejtohen kibles se është në xhenet apo në zjarr, sepse ne nuk e dimë çfarë bën Allahu me robërit e Tij, por ne gjykojmë me kufër për atë që e meriton dhe vepron vepra që janë kufër derisa bëhet murted⁹⁵, ndërsa kush është musliman por bën diçka nga gjynahet e mëdhaja të cilat nuk e nxjerrin nga feja, çështja e tij i takon Allahut, nëse Ai dëshiron e fal ose e dënon. Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Unë jam i dërguari i Allahut e megjithatë pasha Allahun nuk e di se ç`do bëhet me mua!”⁹⁶, pra, ne të tjerët veç tij jemi më parësorë për të mos ditur se ç`do bëhet me ne.

⁹⁴ Transmeton Ahmedî nr 6533, Ebu Daudi nr 4772, saktësoi Albani në Iruaul Galil nr 708.

⁹⁵ Sh.P: Dezertor nga feja. Dikush që bën vepra kufri me bindje.

⁹⁶ Transmeton Buhariu nr 3929.

Përveç nëse Profeti salAllahu alejhi ue selem ka dëshmuar për dikë se ai është në xhenet atëherë dhe ne dëshmojmë për diçka të tillë, duke u bazuar në dëshminë e Profetit salAllahu alejhi ue selem, si p.sh: dhjetë të përgëzuarit me xhenet apo Thabit bin Kajsi⁹⁷ apo gruaja e cila rrëzohej nga të prekurit e xhinëve⁹⁸ ndërsa përsa u përket të tjerëve, për ata që janë punëmirë shpresojmë: mirësi dhe xhenetin, ndërsa kemi frikë për ata që bëjnë të këqija për shkak të veprave të tyre, por çështja e tyre është tek Krijuesi i tyre.

Autori tha: *Kush del para Allahut me ndonjë gjynah që me të meriton zjarrin, por i penduar nga ai mëkat, jo këmbëngulës në të, me të vërtetë Allahu ia pranon atij pendimin sepse Ai e pranon teuben nga robërit e Tij dhe ua fal të këqijat.*

Shpjeguesi thotë: Kush del para Allahut me një gjynah të madh apo me disa gjynahe të mëdhaja por është penduar prej tyre, shpresojmë që pendimi i tij të jetë i pranuar, ndërsa nëse e takon Allahun duke qenë këmbëngulës në atë gjynah çështja e tij i takon Allahut, nëse dëshiron e fal ose e dënon për aq sa i takon që ta shlyejë atë gjynah, por ne besojmë se përfundimi i çdo besimtari njëhsues (muwehid) do jetë në xhenet edhe nëse dënohet për njëfarë kohe në zjarr. Allahu ealem.

Autori tha:

- 1. Kush e takon Allahun pasi që është zbatuar mbi të dënimi në dunja për atë gjynah që ka bërë, i mjafton ai dënim për shlyerjen e atij mëkati, siç ka ardhur në hadithin e Profetit salAllahu alejhi ue selem .*

⁹⁷ Transmeton Buhariu nr 4846

⁹⁸ Transmeton Buhariu nr 5652 dhe Muslimi nr 2576

2. *Kush del para Allahut këmbëngulës në gjynahe, duke mos qenë i penduar prej tyre, të cilat mund ta bëjnë të meritueshëm për tu dënuar, çështja e tij i përket Allahut, nëse do e dënon ose nëse do ia fal atij.*
3. *Kush e takon Allahun duke qenë pabesimtar do dënohet dhe Allahu nuk ia fal atij.*

Shpjeguesi thotë:

1. Hadithi që argumenton për këtë çështje është fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem që u tha atyre që i dhanë besën: “Nëse ndonjëri prej jush bën gjynah për të cilin ka dënim në dunja dhe zbatohet mbi të ai dënim, kjo mjafton si shlyerje e atij gjynahu, nëse Allahu ia mbulon atë gjynah në dunja çështja e tij i përket Allahut, nëse do ia fal atë ose nëse do e dënon”.⁹⁹
2. Ata që bëjnë gjynahe të mëdha çështja e tyre është tek Krijuesi i tyre, nëse do i fal e nëse do i dënon për gjynahet e tyre, pra nëse Allahu dëshiron: dikujt ia fal dhe e fut në xhenet pa dënim ose nëse dëshiron që ta marrë në përgjegjësi për gjynahun e bërë, askush nuk mund ta zbrapsë gjykimin e Tij e as ta kundërshtojë caktimin e Tij, Ai bën ç’të dojë dhe gjykon çfarë të dojë.
3. Tekstet tregojnë se çdo kafir që vdes në kufrin e tij, do të jetë i përjetësuar përgjithmonë në zjarr, nuk del kurrë prej tij. Allahu thotë: “Me të vërtetë punëmirët janë në kënaqësi e mirësi, kurse vepruesit e punëve të këqija janë në zjarr, në të do hyjnë ditën e Llogarisë

⁹⁹ Transmeton Buhariu nr 3892 dhe Muslimi nr 1709.

dhe nuk do mungojnë nga ai për asnjë moment (nuk dalin kurrë prej tij)”(Infitar 13-16).

Autori tha:

1. *Gurëzimi është dispozitë e drejtë dhe e saktë ndaj atij që bën zina pasi që është martuar, nëse e pranon vetë që ka bërë zina ose sillet dëshmia (e qartë e katër dëshmitarëve të besueshëm).*
2. *Profeti salAllahu alejhi ue selem ka gurëzuar*
3. *dhe po ashtu kanë gurëzuar prijësat e drejtë (halifet) pas tij.*

Shpjeguesi thotë:

1. Për gurëzimin është zbritur një ajet kuranor¹⁰⁰ i cili më vonë u anulua si lexim por mbeti në fuqi gjykimi i tij. Profeti salAllahu alejhi ue selem ka gurëzuar, po ashtu halifet pas tij, kështu që është detyrë pranimi dhe zbatimi i këtij gjykimi dhe të mos biem në atë gabim për të cilën kishte frikë Umeri radijAllahu anhu se do të ndodhte¹⁰¹.

¹⁰⁰Ai ajet ishte: “Të moshuarin dhe të moshuarën, nëse bëjnë zina, gurëzojini deri në vdekje, si ndëshkim nga Allahu”. Marrë nga Libri: Studime rreth lëmvive të Kuranit fq 239

¹⁰¹Ka për qëllim transmetimin ku tregohet pohimi i këtij gjykimi nga Umeri nga frika se mos vjen një kohë që të pretendojë dikush shfuqizimin e kësaj dispozite. Transmetohet nga Ibn Abasi nga Umeri radijallahu anhu i cili po qëndronte i ulur në minberin e Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe tha: Vërtetë Allahu e ka dërguar Muhamedin salAllahu alejhi ue selem me të vërtetën dhe i zbriti atij Librin, ku nga ajetet e zbritura në të është dhe ajeti i gurëzimit. Ajet të cilin ne e kemi lexuar, e kemi kuptuar drejtë dhe ishim të ndërgjegjshëm për atë gjë. Profeti salAllahu alejhi ue selem ka gurëzuar dhe ne kemi gurëzuar pas tij, kam frikë se me kalimin e kohës mund të thojë dikush:

2. Profeti salAllahu alejhi ue selem ka gurëzuar Maizin¹⁰², një grua nga fisi Gamedij ¹⁰³, gruan nga fisi Xhuhejne¹⁰⁴ si dhe dy çifutët¹⁰⁵.
3. Me prijësat e drejtë është për qëllim Ebu Bekri, Umeri, Uthmani, Aliu radijAllahu anhum dhe nuk e kanë bërë diçka të tillë veçse ngaqë e kanë ditur vërtetësinë e këtij gjykimi nga Profeti salAllahu alejhi ue selem dhe se ky gjykim nuk është anuluar e as nuk është zëvendësuar, përkundrazi është i vlefshëm deri Ditën e Gjykimit.

Autori tha: *Kush e nënçmon ose ofendon ndonjë nga shokët e Profetit salAllahu alejhi ue selem ose e urren për shkak të diçkaje që mund të ketë bërë ose i përmend të metat e tij, ai është bidatçi dhe do të konsiderohet si i tillë derisa të lutet për ta që Allahu t'i mëshirojë që të gjithë pa përjashtim dhe ta ketë zemrën të pastër ndaj tyre.*

Shpjeguesi thotë: Në këtë pikë imam Ahmedi bëri të qartë se çdokush që urren ndonjë nga sahabët konsiderohet bidatçi, po ashtu ai i cili përmend të metat e tyre dhe nuk i hiqet ky emërtim (bidatçi) derisa të lutet për ta për mëshirë dhe ta ketë zemrën të pastër ndaj tyre, sepse Allahu i ka lavdëruar

Ne nuk e gjejmë gurëzimin në Kuran dhe kështu humbasin nga e vërteta, duke hequr dorë nga një obligim që Allahu e ka zbritur. Vërtetë gurëzimi në Librin e Allahut është i pohuar për atë që bën zina pasiqë ka qenë i martuar, mashkull qoftë apo femër, nëse vërtetohet me faktet e duhura ose nëse ka shtatëzani ose e pohon vetë. Transmeton Muslimi nr 1691

¹⁰² Transmeton Muslimi nr 1692

¹⁰³ Transmeton Muslimi nr 1696

¹⁰⁴ Transmeton Muslimi nr 1696

¹⁰⁵ Transmeton Buhariu nr 6841 dhe Muslimi nr 1699

ata që të gjithë në Librin e Tij, prandaj kush përçmon vlerën e tyre, e ka kundërshtuar Zotin e tij dhe do shijojë gjynahun e bidatit të tij në Ditën që do takojë Zotin e tij.

Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “A po i lini të qetë shokët e mi?! Pasha Atë i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit! Sikur ndonjëri prej jush të shpenzojë flori sa mali i Uhudit nuk do arrijë dot vlerën e shpenzimit të një grushti flori nga ana e tyre, madje as gjysëm grushti”.

Allahu ka thënë: “Allahu ia ka pranuar pendimin Profetit dhe muhaxhirëve e ensarëve të cilët e pasuan në çastet e vështira”(Teube 117).

Autori tha: *Nifaku (hipokrizia) është kufër, dmth: Ta mohojë Allahun dhe të adhurojë dikë tjetër veç Tij dhe shfaq Islamin haptasi, si shembulli i munafikëve të cilët ishin në kohën e Profetit salAllahu alejhi ue selem.*

Shpjeguesi thotë: Nifaku në origjinën gjuhësore është i marrë nga fjala nefek që dmth gjermim në tokë dhe fshehje, u quajt munafiku me këtë emër sepse ai fsheh kufrin dhe shfaq islamin. Allahu ka zbritur ajete të shumta në lidhje me munafikët në suren Teube, Ahzab dhe Munafikun.

Dije se nifaku është dy llojesh:

1. Nifaku në vepër, ky lloj nifaku nuk e nxjerr robin nga islami por konsiderohet si gjynahet e tjera të mëdhaja si p.sh. hadithi ku thuhet: “Cilësitë e munafiku janë tre: Kur flet gënjen, kur premtion e shkel premtimin dhe kur i besohet diçka ai mashtron”¹⁰⁶, në një transmetim

¹⁰⁶ Transmeton Buhariu nr 33 dhe Muslimi nr 59.

tjetër thuhet: “Kur jep besën tradhëton”, në një transmetim tjetër thuhet : “Kur është në konflikt (zënkë, grindje) i kalon kufinjte”¹⁰⁷.

2. Nifaku në besim i cili është shfaqja e Islamit dhe fshehja e kufrit si p.sh.: munafikët që ishin në kohën e Profetit salAllahu alejhi ue selem të cilët kur panë që Profeti fitoi ndaj kurejshëve në luftën e Bedrit thanë: Po shohim që fitorja anoi nga ana e tyre prandaj ejani t'i shfaqim Muhamedit dhe shokëve të tij se jemi me ta dhe e ruajmë të fshehur fenë (besimin) tonë. Ky është nifaku në besim.

Autori tha: *Hadithet si p.sh.: “Kush i ka tre cilësi është munafik” janë për kërcënim, i transmetojmë siç kanë ardhur dhe nuk i komentojmë ato.*

Shpjeguesi thotë: Këto tre cilësi janë ato që i përmenda më lart në hadith: Kur flet gënjen, kur jep besën tradhëton, kur bie në konflikt i kalon kufinjte.

Lind pyetja: Pse u quajtën këto vepra nifak? Sepse ai i cili i flet vëllait të tij duke iu shfaqur gjoja si i vërtetë në fjalën e tij, i është shfaqur me diçka kurse në vetvete ka fshehur diçka tjetër, ka shfaqur të mirën dhe fshehu të keqen.

Ai i cili jep besën dhe në të njëjtën kohë ka për qëllim ta tradhëtojë, pra ka shfaqur diçka të mirë dhe ka fshehur të keqen.

Ai i cili bie në konflikt (grindje, armiqësi) pastaj i kalon kufinjte ka shfaqur të mirën dhe drejtësinë, ndërsa në vete ka të fshehur tejkalinin e kufinjve dhe padrejtësinë, prandaj e

¹⁰⁷Transmeton Buhariu nr 34 dhe Muslimi nr 58.

gjen atë që betohet rrejshëm dhe dëshmon rrejshëm, duke ia bërë të lejuar vetes ato që Allahu i ka ndaluar, si e si që të mbizotërojë ndaj kundërshtarit të tij, prandaj këto cilësi u quajtën nifak sepse janë fshehje e të keqes dhe shfaqje e të mirës.

Autori tha: *Hadithet si p.sh.: “Mos u ktheni në kafira pas vdekjes time duke goditur qafat e njëri tjetrit (duke u vrarë mes jush)” dhe: “Kur dy muslimanë takohen me shpatat e tyre atëherë vrasësi dhe i vrari do të jenë në zjarr” dhe: “Sharja e muslimanit është gjynah kurse vrasja e tij është kufr” dhe: “Kush i thotë vëllait të tij : O kafir, atëherë njëri prej këtyre dyve do e meritojë këtë fjalë” dhe: “Është mohim i Allahut që të mohosh lidhjet farefisnore sado që mund të duket e parëndësishme”, e të tjera si këto hadithe të cilat janë të sakta dhe të memorizuara, i pranojmë ato edhe nëse nuk ua dimë shpjegimin e tyre. Nuk flasim rreth tyre (pa dije), as nuk polemizojmë rreth tyre, nuk i komentojmë këto lloj hadithesh përveçse me çfarë është transmetuar dhe nuk i refuzojmë ato përveç nëse gjejmë diçka më të saktë e më të vërtetë se ato.*

Shpjeguesi thotë: Këto shembuj të cilat i solli autori (Allahu e mëshiroftë) kanë të bëjnë me kufrin e vogël i cili nuk e nxjerr personin nga umeti islam, pra në këto hadithe është përmendur kufrin por pa pasur për qëllim kufrin që të nxjerr nga islami. U quajtën këto gjynahe kufr sepse konsiderohen hedhje poshtë e diçkaje të veçantë, p.sh.: fjala e Profetit salAllahu alejhi ue selem : “Mos u bëni kafira pas vdekjes time”¹⁰⁸ ka për qëllim mohimin (hedhjen poshtë) të lidhjes

¹⁰⁸ Transmeton Buhariu nr 121 dhe Muslimi nr 65.

vëllazërore që ekziston mes muslimanëve për të cilën na ka lajmëruar Allahu duke thënë: “Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër”(Huxhurat 10) dhe ai që lufton vëllain e tij musliman, e ka mohuar (me vepër) këtë vëllazëri besimi. Po ashtu mund të themi për hadithin: “Kur dy muslimanë takohen me shpatat e tyre atëherë vrasësi dhe i vrari do jenë në zjarr”¹⁰⁹, nuk ka për qëllim që do të jenë përjetësisht në zjarr, njësoj themi dhe për shembujt e tjerë.

Më pas imami, Allahu e mëshiroftë, tha se ato hadithe që janë të ngjashme me çfarë i përmendi, që janë të sakta dhe të memorizuara, ne duhet t'i pranojmë edhe nëse nuk ua dimë kuptimin dhe nuk flasim rreth tyre (pa dije), unë them: Të flasësh rreth tyre duke bërë të qartë kuptimin e tyre të vërtetë nuk ka ndonjë pengesë për këtë, p.sh: duke bërë të qartë se ata të cilët do dënohen në zjarr do dalin prej tij e do hyjnë në xhenet edhe nëse rrinë në zjarr një kohë të gjatë që vetëm Allahu e di.

E mësuam më herët që këto vepra janë kufr i vogël, këtu disa gabuan duke e komentuar si kufr që të nxjerr nga islami, kjo është padituri dhe ky është keqkuptimi që ndodhi nga havarixhët.

Duhet që muslimanët t'i kthehen dijetarëve për kuptimin e këtyre çështjeve dhe kam për qëllim me dijetarë ata dijetarë që i njohin hadithet dhe që janë në menhexhin e ehlu sunetit dhe xhematit, Allahu thotë: “Pyesni dijetarët nëse jeni që nuk dini”(Nhal 43).

Me këtë rast është mirë ta dimë se havarixhët dhe të tjerë përveç tyre humbën rrugën në komentimin e Kuranit dhe Sunetit sepse i komentuan sipas dëshirave të tyre, duke mos

¹⁰⁹ Transmeton Buhariu nr 31 dhe Muslimi nr 2888.

u kthyer tek ajo që kanë shpjeguar dijetarët që i njohin hadithet, pasuesit e transmetimeve. Pra, sebepi i humbjes së tyre ishte komenti që ata i bëjnë njëri tjetrit, udhëheqja e njëri tjetrit në injorancë dhe humbje, duke shkatërruar veten dhe të tjerët.

Autori tha:

1. *Xheneti dhe zjarri janë të krijuara dhe ekzistojnë siç ka ardhur në hadithin e Profetit salAllahu alejhi ue selem : “Hyra në Xhenet dhe pashë një pallat”¹¹⁰ dhe: “ Pashë lumin Keuther”¹¹¹ dhe: “vështrova në xhenet dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin..... dhe vështrova në zjarr dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin.....”¹¹².*
2. *Kush pretendon se ato të dyja nuk janë të krijuara, ai është përgënjeshtues i Kuranit dhe i haditheve të Profetit salAllahu alejhi ue selem dhe nuk mendoj se ky person i beson xhenetit dhe zjarrit.*

Shpjeguesi thotë:

1. Xheneti dhe zjarri janë të krijuara që para se të krijoheshin krijesat siç është transmetuar nga Profeti salAllahu alejhi ue selem . Transmetohet nga Buhariu në kapitullin: Mirësitë e Umer bin Hatabit, se Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Mbrëmë hyra në xhenet dhe pashë një pallat floriri. Aty anash qëndronte një grua që po pastrohej, thashë: I kujt është ky pallat? Më thanë: I një arabi. Thashë: Unë jam nga arabët. Pastaj thashë: I kujt është ky pallat? Më

¹¹⁰ Transmeton Buhariu nr 3679.

¹¹¹ Transmeton Muslimi nr 904.

¹¹² Transmeton Muslimi nr 904.

thanë: I një personi nga kurejshët. Thashë: Unë jam nga Kurejshët. Pastaj thashë: I kujt është ky pallat? Më thanë: I Umer bin Hatabit. Desha të hyj brenda tij por kujtova xhelozinë tënde o Umer ndaj u ktheva dhe hoqa dorë. Qau Umeri dhe tha: Për ty të kem xhelozia o i Dërguari i Allahut?!”

Po ashtu ka ardhur në hadithin e namazit të eklipsit: “Mu shfaq mua xheneti në hapësirën e murit saqë për pak desh mora një bistak rrushi dhe sikur ta merrja atë do hanit prej tij deri Ditën e Gjykimit. Mu shfaq mua zjarri dhe pashë në të Amru bin Luhaj¹¹³ që tërhiqte zvarrë zorrët e tij, pashë një grua të gjatë nga fisi Humejr që po çirrej nga një mace. Pyeta: ç’është halli i kësaj gruaje? Thanë: E burgosi macen duke mos i dhënë të hajë e të pijë e as nuk e la të lirë të ushqehet nëpër tokë”¹¹⁴

Po ashtu hadithi tjetër: “Pashë lumin Keuther natën e Israsë, futa dorën në të dhe pashë që balta e tij ishte misk”¹¹⁵ dhe : “Vështrova në xhenet dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin të varfërit”¹¹⁶ dhe : “Vështrova në zjarr dhe pashë që shumica e banorëve të tij ishin gratë”¹¹⁷.

¹¹³ Sh.P: Amr bin Luhaj ishte pari i cili solli idhujt në Gadishullin Arabik pas kohës së Ibrahimit alejhis-selam.

¹¹⁴ Transmeton Muslimi nr 904.

¹¹⁵ Transmeton Muslimi nr 904.

¹¹⁶ Transmeton Buhariu nr 7517.

¹¹⁷ Transmeton Buhariu nr 3241 dhe Muslimi nr 2737.

2. Konsiderohet si i tillë sepse ka përgënjeshtuar Allahun në lajmet e Tij, ka përgënjeshtuar Profetin salAllahu alejhi ue selem në lajmet e tij, Allahu thotë: “Ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, e pa tek Sidratul Munteha, atje është xheneti Me`ua”(Nexhm 13-15).

Autori tha: *Kush vdes nga ehlul kibleh (ata që i drejtohen kibles, dmth që pretendojnë se janë muslimanë) si njëhsues (muwehid) i falet xhenazeja dhe kërkohet falje për të dhe nuk lihet istigfari për të dhe nuk i lihet namazi pa falur për shkak të ndonjë gjynahu që mund të ketë bërë, qoftë ai gjynah i vogël apo i madh, çështja e tij i përket Allahut.*

Shpjeguesi thotë: Kjo sepse shpresohet për çdo musliman njëhsues që të hyjë në xhenet edhe nëse dënohet në zjarr për aq sa i takon të dënohet.

Nuk lejohet të gjykojmë për ata që bëjnë gjynahe të mëdha se janë kafira, përkundrazi është detyrë të besojmë se çdokush i cili vdes si njëhsues që i fal pesë namazet dhe që nuk ka bërë ndonjë gjë që e shemb islamin e personit, atëherë gjykimi për të është si gjykimi për çdo musliman tjetër: i falet namazi i xhenazes kur të vdesë, i përcillet xhenazeja, kërkohet falje për të, shpresojmë për të xhenetin dhe në të njëjtën kohë kemi frikë për të për shkak të gjynaheve të tij.

Muslimani sado gjynahe të bëjë duke mos i konsideruar ato si të lejuara vazhdon të jetë musliman por që do merret në përgjegjësi për gjynahet e tij dhe çështja e tij i përket Allahut: Nëse Ai do, ia fal ose nëse do e dënon, pastaj e fut në xhenet pasiqë të jetë pastruar nga gjynahet.

Është e domosdoshme të njohim se çfarë vepre konsiderohet kufr p.sh: Shirku i madh ose mohimi i një shtylle nga shtyllat e islamit ose nga shtyllat e besimit ose lejimi i diçkaje që

është haram me ixhma (unanimitet) ose bërja haram e diçkaje të lejuar me ixhma, të gjitha këto sjellin kufrin. Po ashtu nënçmimi i Librit të Allahut ose i sheriatit të Allahut ose tallja me diçka nga dispozitat e sheriatit ose lënia e namazit në mënyrë absolute. Të gjitha këto konsiderohen gjëra që e shembin islamin e robit dhe që e bëjnë vepruesin e tyre ose atë që beson diçka të tillë kafir.

Pra, le të ketë kujdes nxënësi i dijes mos t'i përzihen çështjet, sepse pastaj nuk është në gjendje të dallojë mes kufrit të madh dhe të vogël apo shirkut të madh dhe të vogël, nëse i ndodh diçka e tillë do bjerë në tekfir pa e kuptuar as vetë.

Duhet që nxënësi i dijes t'i dallojë këto gjëra ashtu që t'i shpaloset e vërteta dhe ta dijë se çfarë të çon në kufrin e madh dhe të vogël, shirkun e madh dhe të vogël.¹¹⁸

Allahu është Ai që jep sukses, ue salAllahu ue seleme ala nebijina Muhamed ue ala alihi ue sahibih.

¹¹⁸ Sh.p:Në përfundim të këtij libri me plot vlera e lusim Allahun të na bëjë dobi me diturinë e selefëve, dituri e cila është fjalëpakë, por plot urtësi, dituri e cila është rruga e vetme për të dëbuar injorancën dhe pasojat e saj. Një nga dijetarët e hershëm ka thënë:çdo e mirë qëndron në pasimin e selefëve dhe çdo e keqe vjen nga shpikja e atyre që erdhën më pas.

Përmbajtja

Biografi e shkurtër rreth imam Ahmed bin Hanbelit.....	3
Biografia e shejkh Ahmed en-Nexhmij.....	5
Parathënia e shpjguesit.....	14
Hyrje në shpjegimin e Bazave të Sunetit.....	21
Bazat e Sunetit janë:Kapja pas rrugës Profetike.....	22
Të marrësh sahabët për shembull.....	24
Braktisja e bidateve.....	27
Çdo bidat është humbje.....	29
Largimi nga polemikat dhe nga qëndrimi me bidatçinjtë.....	32
Suneti është komentues i Kuranit.....	38
Nuk kundërshtohet Suneti me shembuj logjikë.....	39
Besimi në kader dhe llojet e tij.....	42
Largimi nga polemikat rreth çështjeve të besimit.....	47
Kurani, fjala e Allahut, nuk është e krijuar.....	48

Shikimi i Allahut Ditën e Gjykimit.....	51
Peshorja e Ditës së Gjykimit.....	56
Rezervuari i Profetit në Ditën e Gjykimit.....	57
Pyetjet e varrit dhe dënimi në të.....	58
Ndërmjetësimi i Profetit në Ditën e Gjykimit.....	61
Besimi në daljen e Dexhalit dhe zbritjen e Isait.....	63
Besimi (imani) është fjalë dhe vepër.....	64
Shokët më të mirë të Profetit.....	66
Bindja ndaj prijësave muslimanë.....	69
Nuk lejohet rebelimi ndaj prijësave.....	74
Nuk dëshmojmë për askënd me xhenet apo zjarr.....	76
Ofendimi i sahabëve, mëkat dhe bidat.....	80
Xheneti dhe zjarri ekzistojnë.....	85
Të drejtat e muslimanit.....	87